FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 16	**2000**	**Qershor**

P Ë R M B A J T J A

Ligj nr. 8619, datë 14.6.2000	Për ratifikimin e "Konventës financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Mediocredito Centrale (Itali) për financimin e përbërësve të asistencës teknike për ndërmarrjen e ujrave dhe të ndërhyrjeve infrastrukturore të rrjetit hidrik, në kuadër të projektit të rehabilitimit të rrjetit hidrik të Tiranës"	763
Ligj nr.8620, datë 14.6.2000	Për ratifikimin e "Konventës financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Mediocredito Centrale (Itali) për financimin e përbërësit të ndërhyrjes urgjente në rrjetin hidrik, në kuadër të projektit të rehabilitimit të rrjetit hidrik të Tiranës"	771
Ligj nr.8621, datë 14.6.2000	Për ratifikimin e "Konventës financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Mediocredito Centrale (Itali) për "Programin e ndihmës për të mbështetur sektorët ekonomikë"	778

Ligj nr.8622, datë 14.6.2000 | Për ratifikimin e "Marrëveshjes së huasë ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Eksportfinans-ës (ASA)" | 788

L I G J
Nr.8619, datë 14.6.2000

PËR RATIFIKIMIN E "KONVENTËS FINANCIARE NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE MEDIOCREDITO CENTRALE (ITALI) PËR FINANCIMIN E PËRBËRËSVE TË ASISTENCËS TEKNIKE PËR NDËRMARRJEN E UJËRAVE DHE TË NDËRHYRJEVE INFRASTRUKTURORE TË RRJETIT HIDRIK, NË KUADËR TË PROJEKTIT TË REHABILITIMIT TË RRJETIT HIDRIK TË TIRANËS"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Konventa financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Mediocredito Centrale (Itali) për financimin e përbërësve të asistencës teknike për ndërmarrjen e ujërave dhe të ndërhyrjeve infrastrukturore të rrjetit hidrik, në kuadër të projektit të rehabilitimit të rrjetit hidrik të Tiranës".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2658, datë 19.6.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

Konventë financiare lidhur midis Qeverisë së Republikës të Shqipërisë
dhe Mediocredito Centrale-Instituti Qendor për kreditë afat-Mesme S.P.A.

KONVENTË FINANCIARE

Lidhur në bazë të Nenit të ligjit italian Nr.49, datë 26 Shkurt 1987 midis :

Qeverisë së Republikës të Shqipërisë (me cilësinë e Humarrësit), e përfaqësuar nga Ministri i Financave

nga njëra anë
dhe
nga ana tjetër

Mediocredito Centrale-Istituto Centrale per il Credito a Medio Termine S.P.A., i quajtur në formë të shkurtuar Mediocredito Centrale S.P.A., me seli në Via Piemonte 51 – 00187 Romë, regjistruar në regjistrin tregtar me Nr. 3362/94, në Regjistrin e Bankave me Nr. 74762.6.0, me kapital 2.192.319.400.000 lireta, kodi fiskal Nr. 00594040586 (i cili në këtë konventë do të njihet si Mediocredito Centrale), me cilësinë e administratorit të Fondit në bazë të Nenit 6 të ligjit italian Nr.49,

datë 26 shkurt 1987, përfaqësuar nga

Duke patur parasysh që

Ministria e Thesarit të Qeverisë së Republikës Italiane, me propozim të Ministrisë së Punëve të Jashtme, me dekretin Nr. 622863, datë 09/06/1999, ka autorizuar Mediocredito Centrale t'i japë Qeverisë së Republikës të Shqipërisë nje kredi financiare prej 53.200.000.000 (pesëdhjetë e tre miliardë e dyqind milionë) lireta, me këto kushte :

- Kthimi: në 22 (njëzet e dy) këste gjashtëmujore të barabarta dhe të njëpasnjëshme, ku afati i pagimit të këstit të parë mbaron 294 (dyqind e nëntëdhjetë e katër) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Konvente financiare;
- Përqindja e interesit : 0.50 % (zero presje pesëdhjetë përqind) interes nominal vjetor i cili do të paguhet në fund të gjashtëmujorit ku ky gjashtëmujor fillon nga data e çdo përdorimi;
- Destinacioni: realizimi i një projekti reabilitimi i rrjetit ujor të Tiranës dhe asistencë teknike në administrimin e ndërmjarjes së ujrave për përmirësimin e adiministrimit financiar dhe investimet që lidhen me këtë fushë;
- Valuta e lëvrimit të kredisë : kredia do të lëvrohet në lireta italiane me kursin e këmbimit të Bankës Italiane në bazë të Nenit 2 të ligjit të 12 gushtit 1993, i cili do të jetë i datës dy ditë punë përpara lëvrimit të financimit ;
- Hartimi i kontratave të veçanta do të bëhet me aprovimin paraprak të Ministrisë së Punëve të Jashtme Drejtoria e Përgjithshme e Kooperimit për Zhvillim, më pas do të marrë vlerësimin pozitiv tekniko-ekonomik nga ana e Njësisë Teknike Qëndrore.

Palët bien dakord përsa vijon duke i konsideruar Hyrjen dhe Anekset si pjesë përbërëse të kësaj Konvente:

Neni 1
Kredia fiananciare

1.1. Mediocredito Centrale i jep Huamarrësit, i cili nga ana e tij e pranon, një kredi financiare në vlerën 53.200.000.000 (pesëdhjetë e tre miliardë e dyqind milionë) lireta;

1.2. Kjo kredi do të financojë realizimin e një projekti reabilitimi të rrjetit ujor të Tiranës dhe asistencë teknike në administrimin e ndërmjarjes së ujrave për përmirësimin e adiministrimit financiar dhe investimet që lidhen me këtë fushë;

1.3. Përfshirja përfundimtare e kontratave që lidhen me projektin sipas pikës 1.2., në kredi do i bëhet e ditur me shkrim Huamarrësit dhe Bankës Agjente nga ana e Mediocredito Centrale sapo të kenë përfunduar procedurat e parashikuara nga ligji italian. Kjo përfshirje do të bëhet brenda afatit të parashikuar në Nenin 4, pika 4.2.

1.4. Kredia financiare do të jetë e disponueshme edhe e përdorshme në kohën, mënyrën dhe sipas kushteve të parashikuara në këtë Konventë.

Neni 2
Banka Agjente

2.1. Banka Agjente, lidhur me këtë kredi do të jetë Filiali i Romës i San Paolo Imi. (me cilësinë e Bankës Agjente).

2.2. Në Bankën Agjente do të hapet në emër të Huamarrësit një "Llogari me Jashtë"

2.3. Në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi të shtetit italian, Banka Agjente do të kryejë kontrollin e përputhjes së pagesave që do të bëhen në bazë të kësaj konvente, me legjislacionin valutor që është në fuqi në Itali.

2.4. Banka Agjente do të kryejë pagesat e parashikuara nga kjo Konventë me dorëzimin, nga ana e përfituesve të palës italiane të dokumentacionit të nevojshëm siç parashikohet në kontratën e furnizimit dhe me lëshimin po nga ana e tyre të një deklarate (faturë) që i çliron nga detyrimet, e cila duhet të jetë në dy kopje origjinale. Banka Agjente do të dorëzojë një kopje origjinale të faturës dhe një kopje të dokumentacionit kontraktual tek Mediocredito Centrale dhe do ia dërgojë origjinalin e dytë të faturës dhe dokumentacionit kontraktual Huamarrësit.

Neni 3

Hyrja në fuqi e Konventës financiare

3.1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi sapo Mediocredito Centrale të marrë nga Huamarrësi dokumentet e mëposhtëm :

1. Deklaratën e lëshuar nga organi kompetent i Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, e cila vërteton e firma e hedhur në këtë Konventë është e një personi të autorizuar konform dispozitave ligjore në fuqi në Shqipëri, i cili merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga kjo konventë në emër dhe për llogari të kësaj qeverie, me cilësinë e Huamarrësit.

2. Aktin e caktimit, të lëshuar nga autoriteti kompetent i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, të personit ose personave të autorizuar për të firmosur Njohjen e Borxhit, siç parashikohet ne Nenin 8 dhe dokumentat e tjera të parashikuara në këtë konventë, të cilat i bashkëngjiten në faksimile (Anekset A,B,C dhe E); Ky akt duhet të japë në hollesi emrin dhe profesionin e këtyre personave dhe të shoqërohet nga "depozimi" i firmave të tyre ; Huamarrësi duhet t'i dorëzojë këtë akt, "depozitimin" e firmave, si dhe ndryshimet eventuale edhe Bankës Agjente.

3. Kopje të mandatit, dhënë Bankës Agjente, për të hapur në emër të Huamarrësit një "Llogari me Jashtë" dhe për t'i përdorur fondet e akredituara ekskluzivisht për të kryer pagesat e përcaktuara nga vetë Huamarrësi dhe sipas mënyrave të përcaktuara po nga ai; ky mandat duhet të hartohet në përputhje me Aneksin A, duhet të pranohet shprehimisht nga Banka Agjente dhe po kjo e fundit t'ia konfirmojë me shkrim Mediocredito Centrale.

3.2. Mediocredito Centrale, sapo të marrë dokumentet e përmendur më lart, i komunikon Huamarrësit, Banka Kombëtare Tregëtare (me cilësinë e "Bankës Shqiptare"), me anë të një letre ose telex-i i cili duhet të konfirmohet më pas me letër, dhe Bankës Agjente, datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

3.3. Huamarrësi emëron Bankën Kombëtare Tregëtare me cilësinë e Bankës Agjente e cila do të veprojë si e tillë në emër dhe për llogari të Huamarrësit.

Neni 4

Valuta dhe afatet e përdorimit të kredisë

4.1. Kredia do të lëvrohet në lireta italiane, ashtu siç është parashikuar në hyrje të kësaj Konvente.

4.2. Fondet do të kreditohen, një ose shumë herë, në "Llogarinë me Jashtë" brënda 24 (njëzet e katër) muajve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, me përjashtim të rastit kur ky afat shtyhet me marrëveshje të dy palëve me anë të lëshimit paraprak, nëse është e nevojshme, të autorizimeve nga ana e autoriteve italiane dhe shqiptare.

4.3. Kredia mund të përdoret pas datës së hryjes në fuqi të kësaj Konvente, e cila i komunikohet Huamarrësit, Bankës Shqiptare dhe Bankës Agjente nga ana e Mediocredito Centrale, në bazë të Nenit 3 të kësaj Konvente.

Neni 5

Mënyrat e përdorimit të kredisë : kërkesa e kreditimit të fondeve

5.1. Pas hyrjes në fuqi të Konventës, Banka Shqiptare i dërgon Mediocredit Centrale një kërkesë për vënien në dispozicion të fondeve të nevojshme për të përballuar pagesat e parashikuara nga kontratat e furnizimeve, përfshirja e të cilave në këtë kredi është autorizuar shprehimisht nga autoritetet kompetente italiane dhe i është konfirmuar me shkrim Huamarrësit dhe Bankës Shqiptare, siç është parashikuar në pikën 1.3 të Nenit 1 të kësaj Konvente. Kjo kërkesë hartohet sipas Aneksit bashkëlidhur B).

5.2. Banka Shqiptare i dërgon Bankës Agjente, për secilën nga kontratat, një letër udhëzuese hartuar konform Aneksit bashkëlidhur C), e cila duhet të prahohet shprehimisht nga Banka Agjente me notë verbale dërguar Bankës Shqiptare dhe Mediocredito Centrale.

5.3. Në bazë të udhëzimeve të mësimërme të marra nga Banka Shqiptare, Banka Agjente i kërkon herë pas herë Mediocredito Centrale kreditimin, në "Llogarinë me Jashtë" të Huamarrësit, të

fondeve të nevojshme për të kryer pagesat e parashikuara në kontratën përkatëse të furnizimit, sipas mënyrave të përcaktuara në Nenin 6. Banka Agjente do të hartojë kërkesat e kreditimit konform Aneksit D bashkëlidhur) dhe do i dërgojë kopje Huamarrësit dhe Bankës Shqiptare.

Neni 6

Mënyrat e përdorimit të kredisë: kreditimi i fondeve

6.1. Përdorimi i kredise do të bëhet në përputhje me mënyrat e përcaktuara si më poshtë.

6.2. Pas marrjes së kërkesës për vënien në dispozicion të fondeve (pika 5, Neni 5), Mediocredito Centrale do ekzkutojë kërkesat e kreditimit qe Banka Agjente do të kryejë për llogari të Huamarrësit në bazë të udhëzimeve të marra nga Banka Shqiptare.

6.3. Secila nga kërkesat e kreditimit duhet të përmbajë : numrin dhe datën e kontratës së furnizimit, emrin e importuesit shqiptar dhe eksportuesit italian, shumë e përdorimit, vërtetimin e Bankës Agjente që dokumentet kontraktuale janë të rregullta në përputhje me kontratën e furnizimit së cilës i referohen. Banka Agjente i dërgon Bankës Shqiptare origjinalin e dokumenteve kontraktuale.

6.4. Çdo kërkesë kreditimi do të ekzekutohet brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së saj nga ana e Mediocredito Centrale, me kusht që shumat përkatëse të bëhen të disponueshme nga ana e autoriteteve italiane kompetente.

6.5. Çdo kërkesë kreditimi duhet të paraqitet në përputhje me pagesën që do të kryhet duke iu referuar afatit të kontratës.

6.6. Me marrjen e kërkesës për kreditim, Mediocredito Centrale i jep Bankës Agjente udhëzimet e nevojshme për kreditimin e fondeve në "Llogarinë me Jashtë" hapur pranë saj në emër të Huamarrësit dhe i konfirmon me telex Huamarrësit dhe Bankës Shqiptare shumën e përgjithëshme të përdorimit dhe valutën e kreditimit.

6.7. Në të njëjtën kohë me kreditimin e fondeve në "Llogarinë me Jashtë", Banka Agjente kryen pagesat, në bazë të kontratës së furnizimit për eksportuesit italian dhe u kërkon atyre lëshimin e një deklarate (fature) që e çliron nga detyrimet, në dy kopje origjinale, një nga të cilat i dërgohet Bankës Shqiptare me dokumentacionin kontraktual në bazë të të cilit bëhen pagesat dhe tjetra, së bashku me dokumentacionin kontraktual, i dërgohet Mediocredito Centrale.

6.8. Pas çdo kreditimi fondesh në "Llogarinë me Jashtë" dhe kryerjes së pagesave përkatëse për përfituesit, Mediocredito Centrale i transmeton zyrtarisht Huamarrësit dhe Bankës Shqiptare dhe për dijeni Bankës Agjente, planin e shlyerjes së shumës së lëvruar duke përcaktuar afatet e skadencës. Humarrësi konfirmon me shkrim pranimin e këtij plani shlyrje, hartuar në përputhje me nenin 7.

6.9. Në rast se ditën e parashikuar për kreditim fondesh në "Llogarinë me Jashtë", Banka Agjente nuk mund të kryejë pagesat në favor të përfituesve të mësipërm, ajo nuk do të fillojë kreditimin në bazë të Udhëzimeve të Mediocredito Centrale dhe do të komunikojë menjëherë me shkrim Huamarrësin, Bankën Shqiptare dhe vetë Mediocredito Centrale.

6.10. Me t'u zgjidhur problemi që ka penguar pagesat për përfituesit përkatës, Banka Agjente duhet t'i dergojë Mediocredito Centrale një kërkesë tjetër Kreditimi.

6.11. Në rast se vërehen mospërmbushje detyrimesh në dëm të Mediocredito Centrale në lidhje me këtë kredi ose kredi të tjera financiare të dhëna nga Mediocredito Centrale për Qeverinë ose Bankën Qëndrore ose Entet e Shtetit të Republikën së Shqipërisë, në bazë te Nenit 6 te ligjit italian Nr.49, datë 26.02.1987 dhe ndryshimeve të mëpasshme, Mediocredito Centrale ka të drejtën të mos ekzekutojë kërkesa të tjera kreditimi në "Llogarinë me Jahstë" deri sa këto mospërmbushje ose shkelje të korigjohen, me kusht që afati i përdorimit të mos ketë përfunduar ende.

Neni 7

Kthimi i kredisë dhe pagimi i interesave.

7.1. Çdo shumë e kredituar në "Llogarinë me Jashtë"do të kthehet në bazë të një plani shlyerje që Mediocredito Centrale do t'i transmetojë Huamarrësit, Bankës Shqiptare dhe për dijeni Bankës Agjente, siç parashikohet në pikën 6.8 te Nenit 6 te kësaj Konvente.

7.2. Çdo shumë e kredituar në "Llogarinë me Jashtë" do të kthehet në 22 (njëzet e dy) këste gjashtëmujore, të barabartë dhe të njëpasnjëshëm (kuota kapitali) ku pagesa e kësit të parë skadon 294 (dyqind e nëntëdhjetë e katër) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

7.3. Mbi kuotat kapital (këstet) të çdo kreditimi në "Llogarinë me Jashtë" do të llogariten interesa në masen 0,50% (zero presje pesëdhjetë përqind) në vit, të barabarta me 0,25% (zero presje njëzet e pesë përqind) në fund të gjashtëmujorit, duke filluar nga data e kreditimit dhe deri në datën e kthimit të kuotës së fundit të kapitalit.

7.4. Gjatë periudhës së kthimit, këto interesa do te paguhen në të njëjtën datë skadence me kuotat kapital. Gjatë periudhes se aktivitetit zero, këto interesa do të paguhen në bazë gjashtëmujori në datat që u korrespondojnë me ditë dhe muaj datave te pagimit të kuotave të kapitalit. Në këtë mënyrë , kuota e parë e interesit mund të përkojë me një periudhë më të shkurtër se gjashtëmujori. Megjithatë, në rast se kjo periudhë është më e shkurtër se 30 (tridhjetë) ditë, kjo kuotë interesi do të paguhet me kuotën e mëpasshme të interesit. Kuota e parë e interesit, që i përket një periudhe më të gjatë ose më të shkurtër se gjashtëmujori, do të llogaritet për ditët që efektivisht kanë kaluar nga data e arkëtimit në "Llogarinë me Jashtë" në datën e pagesës, në bazë të një gjashtëmujori prej 180 ditësh.

7.5. Deri në datën e lëshimit të Njohjes së Borxhit (neni 8), pagesa e interesave që lidhen me çdo përdorim do të bëhet në afatet e parashikuara në planet e shlyerjes (pika 6.8, neni 6); menjëhere pas kësaj date, kthimi i kapitalit dhe pagimi i interesave do të bëhen në afatet e parashikuara në planin e shlyerjes të Njohjes së mësipërme të Broxhit.

Neni 8

Lëshimi i Njohjes së Borxhit

8.1. Brenda 60 (gjashtëdhjetë) diteve nga i fundit për përdorimin e kredise (pika 4.2 neni 4), Huamarrësi i lëshojë Mëdiocredito Centrale një Njohje të Borxhit, të firmosur në çdo faqe, të hartuar në përputhje me Aneksin E), e cila duhet të përmbajë këto elemente:

- Shumën si kapital: Njohja e Borxhit përpilohet për një shumë kapitali që i korespondon shumës së gjithë shumave të përdorura;
- Interesi: me kursin e përcaktuar në pikën 7.3 të Nenit 7 të kësaj Konvente;
- Përfitues; me urdhër të Mediocredito Centrale;
- Vendi dhe data e lëshimit; të përcaktohet në momentin e nënshkrimit;
- Adresa: shumat e përcaktuara në Njohjen e Borxhit do të paguhen nga Huamarrësi për Mediocredito Centrale në afatet përkatese, pranë Bankës Agjente;
- Transferueshmëria: para mbarimit të afatit, Njohja e Borxhit është e transferueshme nga Mediocredito Centrale tek persona juridik publik ose privat italianë. Transferimi tek një person juridik publik ose privat i huaj i nënshtrohet miratimit paraprak të Huamarrësit. Është e qartë se Huamarrësi nuk është përgjegjës për çdo shpenzim, komision, taksë ose tatim që rrjedh nga kalimi i Njohjes se Borxhit. Mediocredito Centrale i njofton Bankës Agjente transferimin e Njohjes se Borxhit.
- Mbarimi i afatit dhe plani i shlyerjes së kredisë: plani i shlyerjesnë Njohjen e Borxhit do të hartohet duke mbledhur kuotat e kapitalit dhe interesat që nuk u ka mbaruar ende afati në datën e lëshimit të Njohjes së Borxhit, tëcilat rezultojnë nga planet e veçanta të shlyerjes per çdo përdorim siç parashikuar në pikën 6.8 te Nenit 6 te kësaj Konvente.

8.2. Mediocredito Centrale depoziton Njohjen e Borxhit për ruajtje dhe administrim prane Bankës Agjente, pasi shuma përkatëse të jetë derdhur nga Mediocredito Centrale në favor të kësaj Bankes Agjente.

8.3. Banka Agjente do të regjistrojë në Njohjen e Debisë pagesat që do të bëhen dhe që përfshijnë kapitale dhe interesa dhe, sapo të jenë kryer te gjitha pagesat e parashikuara ne Njohjen e Borxhit, do të marrë masat që t'ia kthejë Huamarrësit kundrejt lëshimit të dëftesës përkatëse.

Neni 9

Vendi dhe mënyrat e pagesës. Detyrime te huamarrësit

9.1. Për gjithë pagesat dhe kthimet që rrjedhin nga kjo Konventë dhe Njohja përkatëse e Debisë, Banka Shqiptare, në emër dhe për llgari te Huammarrësit, ka detyrimin të bëjë në kohën e duhur akreditimin e shumës përkatëse në lireta italiane në favor te vetë Mediocredito Centrale ose te ngarkuara ligjore pranë Bankës Agjente. Këto shuma do te akreditohen duke mos bërë asnjë zbritje për detyrime bankare ose valutore dhe pa nevojën e paralajmërimit nga ana e Mediocredito Centrale

ose të ngarkuarve me ligj.

9.2. Detyrimi i Huamarrësit për të kryer pagesen e shumave në bazë të kësaj Konvente dhe Njohjes se Borxhit perkatësë është autonom, absolut, i pakushtëzuar dhe i parevokueshëm.

Neni 10
Kamatëvonesat

10.1. Në rast se, për një arsye çfarëdo, për të cilën nuk është përgjegjës Mediocredito Centrale, shumat e kapitalit dhe interesave nuk kthehen brenda afatit në Bankën Agjente, Huamarrësi është i detyruar të paguajë kamatëvonesat e këtyre shumave për periudhën midis datës së mbarimit të afatit dhe datës së akreditimit efektiv në favor të Mediocredito Centrale ose të ngarkuarve ligjorë pranë vetë Bankës Agjente.

10.2. Këto kamatëvonesa do të llogariten në masën vjetore prej 0,50% (zero presje pesëdhjetë përqind) për 35 (tridhjetë e pesë) ditët e mëpasshme nga data e mbarimit të afatit fillestar dhe menjëherë më pas, ne masën vjetore prej 5% (pesë përqind) deri në datën e pagesës efektive ne Mediocredito Centrale.

10.3. Për 35 (tridhjetë e pesë) ditët menjëherë të mëpasshme nga data e mbarimit të afatit fillestar, këto kamatvonesa do të llogariten gjithnjë me regjimin e interesave të thjeshtë; për periudhën e mëpasshme, ato do të llogariten me regjimin e interesit të thjeshtë, kur kjo periudhë është më e vogël se një vit, dhe me regjimin e interesit të kombinuar, kur kjo periudhë është më e madhe se një vit.

Neni 11
Barra e taksave

11.1. Çdo barrë taksash qe duhet paguar në të tashmen ose në të ardhmen në Shqipëri, ne zbatim të kësaj Konvente dhe të Njohjes perkatëse te Borxhit, do të jetë në ngarkim te huamarresit.

11.2. Çdo taksë që duhet paguar në Itali nuk është në ngarkim të Huamarrësit.

11.3. Mediocredito Centrale deklaron se i nënshtrohet regjimit tatimor sipas D.P.R. nr. 601, datë 29 shtator 1973 dhe ligjit italian nr. 227, datë 25 maj 1977 dhe ndryshimeve eventuale te tyre.

Neni 12
Mosmarrëveshjet

12.1. Palët angazhohen t'i zgjidhin me mirëkuptim mosmarrëveshjet që mund të lindin nga interpretimi ose/dhe ekzekutimi i kësaj Konvente.

12.2. Nëse kjo nuk arrihet brenda një afati 90(nëntëdhjetë) ditor, mosmarrëveshja do bëhet objekt zgjidhje në nivel qeveritar.

12.3. Ne rast se edhe kjo përpjekje nuk çon në një zgjidhje të kënaqshme, të gjitha mosmarrëveshjet do të zgjidhen perfundimisht në bazë të Rregullores së Pajtimit dhe Arbitrimit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtise së Parisit, Francë, nga një kolegj i përbërë nga 3 arbitra:

- Një që caktohet nga Huamarrësi;
- Një nga Mediocredito Centrale;
- Një që caktohet nga arbitrat e sipërpërmendur ose, ne rast mosmarreveshje midis tyre, nga Presidenti i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë së Parisit.

12.4. Në rast se Huamarrësi ose Mediocredito Centrale nuk kanë caktuar arbitrin e tyre brenda 30 ditëve nga data e kërkesës së palës tjetër, arbitri do të caktohet nga Presidenti i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë së Parisit.

12.5. Vendimi i Kolegjit Abitrar, i cili do të gjykoje në bazë të ligjit italian, është përfundimtar dhe bëhet i detyrueshëm për paët, të cilët nuk gëzojnë të drejtën e ankesës.

12.6. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve, nuk pezullon detyrimin e Huamarrësit për të paguar, në afatet përkatëse, të gjitha detyrimet financiare që rrjedhin nga zbatimi i kësaj Konvente dhe në veçanti detyrimet financiare që rrjedhin nga plani i shlyerjes (pika 6.6 Neni 6) dhe nga Deklarata e Borxhit.

Neni 13
Lajmërimet

13.1. Lajmërimet që do të kryhen në zbatim të kësaj Konvente duhet të drejtohen:

Ministria e Financave
Banka Kombëtare Tregtare

Mediocredito Centrale S.p.a.
– Via Piemonte 51, 00 187 Roma – Italia
n.tel 0039064701592/064791059
nr Swift MCENITRRXXX,

Telefax: 0039064791574/064791380
San Paolo Imi (Banka Agjente)

Neni 14
Origjinalet e Konventës Financiare

14.1. Kjo Konventë është hartuar dhe nënshkruar në katër kopje origjinale në gjuhën italiane dhe katëër në gjuhën angleze. Në rast mospërputhje merret për bazë kopja në gjuhën italiane.

Për Mediocredito Centrale S.p.A
Instituti Qëndror për Kreditë Afat-Mesme

Francesko Anania

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë
Ministria e Financave

Anastas Angjeli

L I G J
Nr.8620, datë 14.6.2000

PËR RATIFIKIMIN E "KONVENTËS FINANCIARE NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE MEDIOCREDITO CENTRALE (ITALI) PËR FINANCIMIN E PËRBËRËSIT TË NDËRHYRJES URGJENTE NË RRJETIN HIDRIK, NË KUADËR TË PROJEKTIT TË REHABILITIMIT TË RRJETIT HIDRIK TË TIRANËS"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "'Konventa financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Mediocredito Centrale (Itali) për financimin e përbërësit të ndërhyrjes urgjente në rrjetin hidrik, në kuadër të projektit të rehabilitimit të rrjetit hidrik të Tiranës".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2659, datë 19.6.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

KONVENTE FINANCIARE

Lidhur në bazë të Nenit 6 të ligjit Nr.49, datë 26 Shkurt 1987 midis :
Qeverisë së Republikës të Shqipërisë (me cilësinë e Humarrësit), e përfaqësuar nga Ministri i Financave

nga njëra anë
dhe
nga ana tjetër

Mediocredito Centrale-Istituto Centrale per il Credito a Medio Termine S.P.A., i quajtur në formë të shkurtuar Mediocredito Centrale S.P.A., me seli në Via Piemonte 51 – 00187 Romë, regjistruar në regjistrin tregtar me Nr. 3362/94, në Regjistrin e Bankave me Nr. 74762.6.0, me kapital 2.192.319.400.000 lireta, kodi fiskal Nr. 00594040586 (i cili në këtë konventë do të njihet si Mediocredito Centrale), me cilësinë e administratorit të Fondit në bazë të Nenit 6 të ligjit italian Nr.49, datë 26 shkurt 1987, përfaqësuar nga dr.Francesko Anania.

Duke patur parasysh që

Ministria e Thesarit të Qeverisë së Republikës Italiane, me propozim të Ministrisë së Punëve të Jashtme, me dekretin Nr. 636044, datë 05/10/1999, ka autorizuar Mediocredito Centrale t'i japë Qeverisë së Republikës së Shqipërisë një kredi financiare prej 6.800.000.000 (gjashtë miliardë e tetëqind milionë) lireta, me këto kushte :

- Kthimi : në 22 (njëzet e dy) këste gjashtëmujore të barabarta dhe të njëpasnjëshme, ku afati i pagimit të kështit të parë mbaron 294 (dyqind e nëntëdhjetë e katër) muaj pas datës së hyrjes në

fuqi të kësaj Konvente financiare;

- Përqindja e interesit : 0.50 % (zero presje pesëdhjetë përqind) interes nominal vjetor i cili do të paguhet në fund të gjashtëmujorit ku ky gjashtëmujor fillon nga data e çdo përdorimi;
- Destinacioni : realizimi i projektit për rehabilitimin e rrjetit të shpërndarjes së ujit në Tiranë;
- Valuta e lëvrimit të kredisë : kredia do të lëvrohet në lireta italiane me kursin e këmbimit të Bankës Italiane në bazë të Nenit 2 të ligjit të 12 gushtit 1993, i cili do të jetë i datës dy ditë punë përpara lëvrimit të financimit;
- Hartimi i kontratave të veçanta do të bëhet me aprovimin paraprak të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Drejtoria e Përgjithshme e Kooperimit për Zhvillim, më pas do të marrë vlerësimin pozitiv tekniko-ekonomik nga ana e Njësisë Teknike Qendrore.

Palët bien dakord përsa vijon duke i konsideruar Hyrjen dhe Anekset si pjesë përbërëse të kësaj Konvente.

Neni 1
Kredia fiananciare

1.1. Mediocredito Centrale i jep Huamarrësit, i cili nga ana e tij e pranon, një kredi financiare në vlerën 6.800.000.000 (gjashtë miliardë e tetëqind milionë) lireta.

1.2. Kjo kredi do të financojë realizimin e projektit për reabilitimin e rrjetit të shpërndarjes së ujit në Tiranë.

1.3. Përfshirja përfundimtare e kontratave që lidhen me projektin sipas pikës 1.2., në kredi do i bëhet e ditur me shkrim Huamarrësit dhe Bankës Agjente nga ana e Mediocredito Centrale sapo të kenë përfunduar procedurat e parashikuara nga ligji italian. Kjo përfshirje do të bëhet brenda afatit të parashikuar në Nenin 4, pika 4.2.

1.4. Kredia financiare do të jetë e disponueshme edhe e përdorshme në kohën, mënyrën dhe sipas kushteve të parashikuara në këtë Konventë.

Neni 2
Banka Agjente

2.1. Banka Agjente, lidhur me këtë kredi do të jetë Filiali i Romës i San Paolo Imi. (me cilësinë e Bankës Agjente).

2.2. Në Bankën Agjente do të hapet në emër të Huamarrësit një “Llogari me Jashtë” .

2.3. Në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi të shtetit italian, Banka Agjente do të kryejë kontrollin e përputhjes së pagave që do të bëhen në bazë të kësaj konvente, me legjislacionin valutor që është në fuqi në Itali.

2.4. Banka Agjente do të kryejë pagesat e parashikuara nga kjo Konventë me dorëzimin, nga ana e përfituesve të palës italiane të dokumentacionit të nevojshëm siç parashikohet në kontratën e furnizimit dhe me lëshimin po nga ana e tyre e një deklarate (faturë) që i çliron nga detyrimet, e cila duhet të jetë në dy kopje origjinale. Banka Agjente do të dorëzojë një kopje origjinale të faturës dhe një kopje të dokumentacionit kontraktual tek Mediocredito Centrale dhe do ia dërgojë origjinalin e dytë të faturës dhe dokumentacionit kontraktual Huamarrësit.

Neni 3
Hyrja në fuqi e Konventës financiare

3.1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi sapo Mediocredito Centrale të marrë nga Huamarrësi dokumentet e mëposhtme:

1. Deklaratën e lëshuar nga organi kompetent i Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, e cila vërteton se firma e hedhur në këtë Konventë është e një personi të autorizuar konform dispozitave ligjore në fuqi në Shqipëri, i cili merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga kjo konventë në emër dhe për llogari të kësaj qeverie, me cilësinë e Huamarrësit.

2. Aktin e caktimit, të lëshuar nga autoriteti kompetent i Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, të personit ose personave të autorizuar për të firmosur Njohjen e Borxhit, siç parashikohet në Nenin 8 dhe dokumentet e tjera të parashikuara në këtë konventë, të cilat i bashkëngjiten në faksimile (Anekset

A,B,C dhe E). Ky akt duhet të japë në hollësi emrin dhe profesionin e këtyre personave dhe të shoqërohet nga "depozimit" i firmave të tyre ; Huamarrësi duhet t'i dorëzojë këtë akt, "depozitimin" e firmave, si dhe ndryshimet eventuale edhe Bankës Agjente.

3. Kopje të mandatit, dhënë Bankës Agjente, për të hapur në emër të Huamarrësit një "Llogari me Jashtë" dhe për t'i përdorur fondet e akredituara ekskluzivisht për të kryer pagesat e përcaktuara nga vetë Huamarrësi dhe sipas mënyrave të përcaktuara nga po ai; ky mandat duhet të hartohet në përputhje me Aneksin A, duhet të pranohet shprehimisht nga Banka Agjente dhe po kjo e fundit t'ia konfirmojë me shkrim Mediocredito Centrale.

3.2. Mediocredito Centrale, sapo të marrë dokumentet e përmendur më lart, i komunikon Huamarrësit, Banka Kombëtare Tregëtare (me cilësinë e "Bankës Shqiptare"), me anë të një letre ose telex-i i cili duhet të konfirmohet më pas me letër, dhe Bankës Agjente, datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

3.3. Huamarrësi emëron Bankën Kombëtare Tregëtare me cilësinë e Bankës Agjente e cila do të veprojë si e tillë në emër dhe për llogari të Huamarrësit.

Neni 4

Valuta dhe afatet e përdorimit të kredisë

4.1. Kredia do të lëvrohet në lireta italiane, ashtu siç është parashikuar në hyrje të kësaj Konvente.

4.2. Fondet do të kreditohen, një ose shumë herë, në "Llogarinë me Jashtë" brënda 24 (njëzet e katër) muajve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, me përjashtim të rastit kur ky afat shtyhet me marrëveshje të dy palëve me anë të lëshimit paraprak, nëse është e nevojshme, të autorizimeve nga ana e autoriteve italiane dhe shqiptare.

4.3. Kredia mund të përdoret pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, e cila i komunikohet Huamarrësit, Bankës Shqiptare dhe Bankës Agjente nga ana e Mediocredito Centrale, në bazë të Nenit 3 të kësaj Konvente.

Neni 5

Mënyrat e përdorimit të kredisë: kërkesa e kreditimit të fondeve

5.1. Pas hyrjes në fuqi të Konventës, Banka Shqiptare i dërgon Mediocredito Centrale një kërkesë për vënien në dispozicion të fondeve të nevojshme për të përballuar pagesat e parashikuara nga kontratat e furnizimeve, përfshirja e të cilave në këtë kredi është autorizuar shprehimisht nga autoritetet kompetente italiane dhe i është konfirmuar me shkrim Huamarrësit dhe Bankës Shqiptare, siç është parashikuar në pikën 1.3 të Nenit 1 të kësaj Konvente. Kjo kërkesë hartohet sipas Aneksit bashkëlidhur B).

5.2. Banka Shqiptare i dërgon Bankës Agjente, për secilën nga kontratat, një letër udhëzuese hartuar konform Aneksit bashkëlidhur C), e cila duhet të prahohet shprehimisht nga Banka Agjente me notë verbale dërguar Bankës Shqiptare dhe Mediocredito Centrale.

5.3. Në bazë të udhëzimeve të mësimërme të marra nga Banka Shqiptare, Banka Agjente i kërkon herë pas herë Mediocredito Centrale kreditimin, në "Llogarinë me Jashtë" të Huamarrësit, të fondeve të nevojshme për të kryer pagesat e parashikuara në kontratën përkatëse të furnizimit, sipas mënyrave të përcaktuara në Nenin 6. Banka Agjente do të hartojë kërkesat e kreditimit konform Aneksit D) dhe do i dërgojë kopje Huamarrësit dhe Bankës Shqiptare.

Neni 6

Mënyrat e përdorimit të kredisë : kreditimi i fondeve

6.1. Përdorimi i kredisë do të bëhet në përputhje me mënyrat e përcaktuara si më poshtë.

6.2. Pas marrjes së kërkesës për vënien në dispozicion të fondeve (pika 5, Neni 5), Mediocredito Centrale do ekzkutojë kërkesat e kreditimit që Banka Agjente do të kryejë për llogari të Huamarrësit në bazë të udhëzimeve të marra nga Banka Shqiptare.

6.3. Secila nga kërkesat e kreditimit duhet të përmbajë : numrin dhe datën e kontratës së furnizimit, emrin e importuesit shqiptar dhe eksportuesit italian, shumën e përdorimit, vërtetimin e

Bankës Agjentë që dokumentet kontraktuale janë të rregullta në përputhje me kontratën e furnizimit së cilës i referohen. Banka Agjente i dërgon Bankës Shqiptare origjinalin e këtyre dokumenteve kontraktuale.

6.4. Çdo kërkesë kreditimi do të ekzekutohet brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së saj nga ana e Mediocredito Centrale, me kusht që shumat përkatëse të bëhen të disponueshme nga ana e autoriteteve italiane kompetente.

6.5. Çdo kërkesë kreditimi duhet të paraqitet në përputhje me pagesën që do të kryhet duke iu referuar afatit të kontratës.

6.6. Me marrjen e kërkesës për kreditim, Mediocredito Centrale i jep Bankës Agjente udhëzimet e nevojshme për kreditimin e fondeve në "Llogarinë me Jashtë" hapur pranë saj në emër të Huamarrësit dhe i konfirmon me telex Huamarrësit dhe Bankës Shqiptare shumën e përgjithshme të përdorimit dhe valutën e kreditimit.

6.7. Në të njëjtën kohë me kreditimin e fondeve në "Llogarinë me Jashtë", Banka Agjente kryen pagesat, në bazë të kontratës së furnizimit për eksportuesit italian dhe u kërkon atyre lëshimin e një deklarate (fature) që e çliron nga detyrimet, në dy kopje origjinale, një nga të cilat i dërgohet Bankës Shqiptare me dokumentacionin kontraktual në bazë të të cilit bëhen pagesat dhe tjetra, së bashku me dokumentacionin kontraktual, i dërgohet Mediocredito Centrale.

6.8. Pas çdo kreditimi fondesh në "Llogarinë me Jashtë" dhe kryerjes së pagesave përkatëse për përfituesit, Mediocredito Centrale i transmeton zyrtarisht Huamarrësit dhe Bankës Shqiptare dhe për dijeni Bankës Agjente, planin e shlyerjes së shumës së lëvruar duke përcaktuar afatet e skadencës. Humarrësi konfirmon me shkrim pranimin e këtij plani shlyrjeje, hartuar në përputhje me nenin 7.

6.9. Në rast se ditën e parashikuar për kreditim fondesh në "Llogarinë me Jashtë", Banka Agjente nuk mund të kryejë pagesat në favorë të përfituesve të mësipërm, ajo nuk do të fillojë kreditimin në bazë të Udhëzimeve të Mediocredito Centrale dhe do të komunikojë menjëherë me shkrim Huamarrësin, Bankën Shqiptare dhe vetë Mediocredito Centrale.

6.10. Me t'u zgjidhur problemi që ka penguar pagesat për përfituesit përkatës, Banka Agjente duhet t'i dergojë Mediocredito Centrale një kërkesë tjetër Kreditimi.

6.11. Në rast se vërehen mospërmbushje detyrimesh në dëm të Mediocredito Centrale në lidhje me këtë kredi ose kredi të tjera financiare të dhëna nga Mediocredito Centrale për Qeverinë ose Bankën Qendrore ose Entet e Shtetit të Republikën së Shqipërisë, në bazë te Nenit 6 te ligjit italian Nr.49, datë 26.02.1987 dhe ndryshimeve të mëpasshme, Mediocredito Centrale ka të drejtën të mos ekzekutojë kërkesa të tjera kreditimi në "Llogarinë me Jashtë" deri sa këto mospërmbushje ose shkelje të korigjohen, me kusht që afati i përdorimit të mos ketë përfunduar ende.

Neni 7

Kthimi i kredisë dhe pagimi i interesave.

7.1. Çdo shumë e kredituar në "Llogarinë me Jashtë" do të kthehet në bazë të një plani shlyerjeje që Mediocredito Centrale do i transmetojë Huamarrësit, Bankës Shqiptare dhe për dijeni Bankës Agjente, siç parashikohet në pikën 6.8 të Nenit 6 të kësaj Konvente.

7.2. Çdo shumë e kredituar në "Llogarinë me Jashtë" do të kthehet në 22 (njëzet e dy) këste gjashtëmujore, të barabartë dhe të njëpasnjëshëm (kuota kapitali) ku pagesa e kësit të parë skadon 294 (dyqind e nëntëdhjetë e katër) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

7.3. Mbi kuotat kapital (kështet) të çdo kreditimi në "Llogarinë me Jashtë" do të llogariten interesa në masën 0,50% (zero presje pesëdhjetë përqind) në vit, të barabarta me 0,25% (zero presje njëzet e pesë përqind) në fund të gjashtëmujorit, duke filluar nga data e kreditimit dhe deri në datën e kthimit të kuotës së fundit të kapitalit.

7.4. Gjatë periudhës së kthimit, këto interesa do të paguhen në të njëjtën datë skadence me kuotat kapital. Gjatë periudhës së aktivitetit zero, këto interesa do të paguhen në bazë gjashtëmujorit në datat që u korrespondojnë me ditë dhe muaj datave të pagimit të kuotave të kapitalit. Në këtë mënyrë , kuota e parë e interesit mund të përkojë me një periudhë më të shkurtër se gjashtëmujori. Megjithatë, në rast se kjo periudhë është më e shkurtër se 30 (tridhjetë) ditë, kjo kuotë interesi do të paguhet me kuotën e mëpasshme të interesit. Kuota e pare e interesit, që i përket një periudhe më të gjatë ose më të shkurtër se gjashtëmujori, do të llogaritet për ditët që efektivisht kanë kaluar nga data e arkreditimit në "Llogarinë me Jashtë" në datën e pagesës, në bazë të një gjashtëmujori prej 180

ditësh.

7.5. Deri në datën e lëshimit të Njohjes së Borxhit (neni 8), pagesa e interesave që lidhen me çdo përdorimi do të bëhet në afatet e parashikuara në planet e shlyerjes (pika 6.8, neni 6); menjëherë pas kësaj date, kthimi i kapitalit dhe pagimi i interesave do të bëhen në afatet e parashikuara në planin e shlyerjes së Njohjes së mësipërme të Boxhit.

Neni 8

Lëshimi i Njohjes së Borxhit

8.1. Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga i fundit për përdorimin e kredise (pika 4.2 neni 4), Huamarrësi do t'i lëshojë Mediocredito Centrale një Njohje të Borxhit, të firmosur në çdo faqe, të hartuar në perputhje me Aneksin E), e cila duhet të përmbajë këto elemente:

- Shumën si kapital: Njohja e Borxhit përpilohet për një shumë kapitali që korrespondon shumës së gjithë shumave të përdorura;
- Interesi: me kursin e përcaktuar ne pikën 7.3 të Nenit 7 të kësaj Konvente;
- Përfitues; me urdhër të Mediocredito Centrale;
- Vendi dhe data e lëshimit; të përcaktohet në momentin e nënshkrimit;
- Adresa: shumat e përcaktuara në Njohjen e Borxhit do të paguhen nga Huamarrësi për Mediocredito Centrale në afatet përkatëse, pranë Bankës Agjente;
- Transferueshmëria: para mbarimit të afatit, Njohja e Borxhit është e transferueshme nga Mediocredito Centrale tek persona juridik publik ose privat italianë. Transferimi tek një person juridik publik ose privat i huaj i nënshtrohet miratimit paraprak të Huamarrësit. Është e qartë se Huamarrësi nuk është përgjegjës për çdo shpenzim, komision, taksë ose tatim që rrjedh nga kalimi i Njohjes se Borxhit. Mediocredito Centrale i njofton Bankës Agjente transferimin e Njohjes së Borxhit.
- Mbarimi i afatit dhe plani i shlyerjes së kredisë: plani i shlyerjes në Njohjen e Borxhit do të hartohet duke mbledhur kuotat e kapitalit dhe interesat që nuk u ka mbaruar ende afati në datën e lëshimit të Njohjes së Borxhit, të cilat rezultojnë nga planet e veçanta të shlyerjes për çdo përdorim siç parashikuar në pikën 6.8 te Nenit 6 te kësaj Konvente.

8.2. Mediocredito Centrale depoziton Njohjen e Borxhit për ruajtje dhe administrim pranë Bankës Agjente, pasi shuma përkatëse të jetë derdhur nga Mediocredito Centrale në favor të kësaj Bankes Agjente.

8.3. Banka Agjente do të regjistrojë në Njohjen e Debisë pagesat që do të bëhen dhe që përfshijnë kapitale dhe interesa dhe, sapo të jenë kryer te gjitha pagesat e parashikuara në Njohjen e Borxhit, do të marrë masat që t'ia ktheje Huamarrësit kundrejt lëshimit të dëftesës përkatëse.

Neni 9

Vendi dhe mënyrat e pagesës. Detyrime të huamarrësit

9.1. Për gjithë pagesat dhe kthimet që rrjedhin nga kjo Konventë dhe Njohja përkatëse e Debisë, Banka Shqiptare, në emër dhe për llogari të Huammarrësit, ka detyrimin të bëjë në kohën e duhur akreditimin e shumës përkatëse në lireta italiane në favor të vetë Mediocredito Centrale ose të ngarkuar dhe ligjor pranë Bankës Agjente. Këto shuma do të akreditohen duke mos bërë asnjë zbritje për detyrime bankare ose valutore dhe pa nevojën e paralajmërimit nga ana e Mediocredito Centrale ose të ngarkuarve me ligj.

9.2. Detyrimi i Huamarrësit për të kryer pagesën e shumave në bazë të kësaj Konvente dhe Njohjes së Borxhit përkatës është autonom, absolut, i pakushtëzuar dhe i parevokueshëm.

Neni 10

Kamatvonesat

10.1. Në rast se, për një arsye çfarëdo, për të cilën nuk është përgjegjës Mediocredito Centrale, shumat e kapitalit dhe interesave nuk kthehen brenda afatit në Bankën Agjente, Huamarrësi është i detyruar të paguajë kamatvonesat e këtyre shumave për periudhën midis datës së mbarimit të

afatit dhe datës së akreditimit efektiv në favor te Mediocredito Centrale ose të ngarkuarve ligjorë pranë vetë Bankës Agjente.

10.2. Këto kamatëvonesa do të llogariten në masën vjetore prej 0,50% (zero presje pesëdhjetë përqind) për 35 (tridhjetë e pesë) ditët e mëpasshme nga data e mbarimit të afatit fillestar dhe menjëherë më pas, në masën vjetore prej 5% (pesë përqind) deri në datën e pagesës efektive në Mediocredito Centrale.

10.3. Për 35 (tridhjetë e pesë) ditët menjëherë të mëpasshme nga data e mbarimit të afatit fillestar, këto kamatvonesa do të llogariten gjithnjë me regjimin e interesave të thjeshta; për periudhën e mëpasshme, ato do të llogariten me regjimin e interesit të thjeshtë, kur kjo periudhë është më e vogël se një vit, dhe me regjimin e interesit të kombinuar, kur kjo periudhë është më e madhe se një vit.

Neni 11
Barra e taksave

11.1. Çdo barrë taksash që duhet paguar në të tashmen ose në të ardhmen në Shqipëri, në zbatim të kësaj Konvente dhe të Njohjes përkatëse të Borxhit, do të jetë në ngarkim të huamarrësit.

11.2. Çdo taksë që duhet paguar në Itali nuk është në ngarkim të Huamarrësit.

11.3. Mediocredito Centrale deklaron se i nënshtrohet regjimit tatimor sipas D.P.R. nr. 601, datë 29 shtator 1973 dhe ligjit italian Nr. 227, datë 25 maj 1977 dhe ndryshimeve eventuale te tyre.

Neni 12
Mosmarrëveshjet

12.1. Palët angazhohen t'i zgjidhin me mirëkuptim mosmarrëveshjet që mund të lindin nga interpretimi ose/dhe ekzekutimi i kësaj Konvente.

12.2. Nëse kjo nuk arrihet brënda një afati 90(nëntëdhjëtë) ditor, mosmarrëveshja do bëhet objekt zgjidhjeje në nivel qeveritar.

12.3. Në rast se edhe kjo përpjekje nuk çon në një zgjidhje të kënaqshme, të gjitha mosmarrëveshjet do të zgjidhen perfundimisht në bazë të Rregullores së Pajtimit dhe Arbitrimit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregëtise së Parisit, Francë, nga një kolegj i përbërë nga 3 arbitra:

- Një që është caktuar nga Huamarrësi;
- Një nga Mediocredito Centrale;
- Një që është caktuar nga arbitrat e sipërpërmendur ose, në rast mosmarreveshjeje midis tyre nga Presidenti i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë së Parisit.

12.4. Në rast se Huamarrësi ose Mediocredito Centrale nuk kanë caktuar arbitrin e tyre brenda 30 ditëve nga data e kërkesës së palës tjetër, arbitri do të caktohet nga Presidenti i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë së Parisit.

12.5. Vendimi i Kolegjit Abritrar, i cili do të gjykojë në bazë të ligjit italian, është përfundimtar dhe bëhet i detyrueshëm për palët, të cilët nuk gëzojnë të drejtën e ankesës.

12.6. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve, nuk pezullon detyrimin e Huamarrësit për të paguar në afatet përkatëse të gjitha detyrimet financiare që rrjedhin nga zbatimi i kësaj Konvente dhe në veçanti detyrimet financiare që rrjedhin nga plani i shlyerjes (pika 6.6, Neni 6) dhe nga Deklarata e Borxhit.

Neni 13
Lajmërimet

13.1. Lajmërimet që do të kryhen në zbatim të kësaj Konvente duhet të drejtohen:

Ministria e Financave
Banka Kombëtare Tregtare

Mediocredito Centrale S.p.a. – Via Piemonte 51, 00 187 Roma – Italia
n.tel 0039064791592/064791059 nr Swift MCENITRRXXX,
Telefax: 0039064791574/064791380

San Paolo Imi (Banka Agjente)

Neni 14
Origjinalet e Konventës Financiare

14.1. Kjo Konventë është hartuar dhe nënshkruar në katër kopje origjinale në gjuhën italiane dhe katër në gjuhën angleze. Në rast mospërputhjeje merret për bazë kopja në gjuhën italiane.

Për Mediocredito Centrale Instituti Qendror për Kreditë Afat-Mesme S.p.a.	Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë Ministria e Financave
Dr.Francesko Anania	**Anastas Angjeli**

L I G J
Nr.8621, datë 14.6.2000

PËR RATIFIKIMIN E "KONVENTËS FINANCIARE NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE MEDIOCREDITO CENTRALE (ITALI) PËR "PROGRAMIN E NDIHMËS PËR TË MBËSHTETUR SEKTORËT EKONOMIKË""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Konventa financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Mediocredito Centrale (Itali) për "Programin e ndihmës për të mbështetur sektorët ekonomikë"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2660, datë 19.6.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

KONVENTË FINANCIARE

Lidhur në bazë të Nenit 6 të ligjit Italian Nr. 49, datë 26 shkurt 1987 midis :
Ministrisë së Financave, me selinë në Tiranë (me cilësinë e huamarrësit), agjent në emër dhe për llogari të Qeverisë së Republikës të Shqipërise e cila përfaqësohet nga Ministri i Financave

Nga njëra anë
Dhe

Mediocredito Centrale S.p.a. Shoqëri Aksionere e Grupit Bancaroma, i regjistruar në Regjistrin e Bankave, me kapital social 2.757.711.840.000, me seli në Via Piemonte 51-00187 Romë, regjistruar në regjistrin Tregtar me Nr. 3362/94, P.IVA 00915101000, Kodi Fiskal Nr. 00594040586 (I cili në këtë konventë do të njihet si Mediocredito Centrale) me cilësinë e administratorit të Fondit të krijuar në bazë të nenit 6 të Ligjit Italian Nr. 49, datë 26 Shkurt 1987, përfaqësuar nga dr.Francesko Anania

nga ana tjetër.

Duke patur parasysh që:

- Ministria e Thesarit të Qeverisë së Republikës Italiane, me propozim të Ministrisë së Punëve të Jashtme me Dekretin Nr. 200617, datë 06.03.2000, ka autorizuar Mediocredito Centrale t'i japë Qeverisë së Republikës të Shqipërisë një kredi financiare prej 22.000.000.000 (njëzet e dy miliardë) lireta me këto kushte:
- Kthimi: në 26 (njëzet e gjashtë) këste gjashtëmujore të barabarta dhe të njëpasnjëshme, ku afati i pagimit të kështit të parë mbaron 330 (treqind e tridhjetë) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Konvente Financiare;
- Përqindja e interesit : 0.25 % (zero presje njëzet e pesë për qind) interes nominal vjetor i cili do të paguhët në fund të gjashtëmujorit ku ky gjashtëmujor fillon nga data e çdo përdorimi;
- Destinacioni: Program ndihme në mbështetje të disa sektorëve ekonomikë;
- Valuta e lëvrimit të kredisë: Kredia do të lëvrohet në lireta italiane;
- Hartimi i kontratave të veçanta do të bëhet me aprovimin paraprak të Ministrisë së Punëve të Jashtme – Drejtorisë së Përgjithshme të Kooperimit për Zhvillim;
- Hartimi i kontratës me aktivitetin e programit të ndihmës, i financuar nga kjo kredi, do të bëhet me aprovimin paraprak me Minsitrinë e Punëve të Jashtme – Drejtorisë së Përgjithshme të Kooperimit për Zhvillim;
- Hyrja në fuqi e kësaj Konvente Financiare duhet t'i nënshtrohet nënshkrimit midis Autoriteteve Shqiptare dhe atyre Italiane të një Memorandumi Teknik në të cilin do të përcaktohen modalitete operative të Programit të Ndihmës.

Palët bien dakord përsa vijon duke i konsideruar Hyrjet dhe Anekset si pjesë përbërëse e kësaj Konvente :

Neni 1
Përkufizime

Në kuadër të kësaj Konvente Financiare dhe të Anekseve bashkëngjitur, terminologjia e përdorur do të ketë këtë kuptim :

- "Banka Agjente" është Banka më Filialin në (Romë), e caktuar nga Huamarrësi siç është parashikuar në Anekset A dhe C, dhe pranë së cilës do të hapet në emër të vetë Huamarrësit një llogari rrjedhëse (e quajtur "Llogari me Jashtë") për akreditimin e fondeve të nevojshme për kryerjen e pagesave të parashikuara në Kontrat Tregtare;
- "Kontrata Tregtare: është/janë kontrata e furnizimit të të mirave dhe/ose shërbimeve nga ana e eksportuesve Italianë për importuesit shqiptarë, që lidhen me realizimin e Programit të Ndihmës;
- "Autoritetet Kompetente Italiane": janë Ministria e Punëve të Jashtme (Organi Kompetent i Kooperacionit : Drejtoria e Përgjithshme e Kooperimit për Zhvillim, Komiteti Drejtues, etj …) dhe/ose Ministria e Thesarit dhe/ose ente të tjera italiane që i parashikon ligji;
- "Konventë Financiare" : Është kjo konventë Financiare, Hyrja së bashku me Anekset të cilat janë pjesë përbërëse e saj;
- "Kredi Financiare": është financimi që Mediocredito Centrale, në bazë të autorizimit të dhënë nga Ministria e Thesarit, me propozim të Ministrisë së Punëve të Jashtme, jep sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në Hyrje dhe në Nenin 2 të kësaj Konvente Financiare;
- "Deklarata e borxhit" : është deklarata e cilësuar në Nenin 8, me të cilën Huamarrësi merr

detyrimin karshi Mediocredito Centrale për të kthyer kuotat kapital dhe interesat e kësaj Kredie Financiare;

- "Dokumentacioni kontraktual": është dokumentacioni i parashikuar në Kontratën Tregtare dhe që përfshin mënyrat e pagesës (p.sh. faturat, packing list, gjendjen e ecurisë etj ….);
- "Periudha e qetësisë" : është periudha e cila fillon nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente Financiare dhe përfundon 330 (treqind e tridhjetë) muaj nga kjo datë, siç është përcaktuar në Hyrje;
- "Programi i Ndihmës" : është programi i zhvillimit për të cilin kanë rënë dakord Qeveria e Republikës Italiane dhe Qeveria Shqiptare, i financuar në një pjesë nga Kredia Financiare.
- "Programme Management Unit-PMU" : është njësia teknike e caktuar nga Qeveria Shqiptare, që do të merret me drejtimin dhe koordinimin lokal të aktiviteteve të Programit Ndihmë.
- "Banka Italo-Shqiptare": është Banka e Huamarrësit në Shqipëri.

Neni 2
Kredia financiare

1.1. Mediocredito Centrale i jep Huamarrësit, i cili nga ana e tij pranon, një kredi financiare në vlerën 22.000.000.000 (njëzet e dy miliardë) lireta.

1.2. Kjo kredi do të financojë Kontratat Tregtare në lidhje me Programin e Ndihmës për të mbështetur sektorët ekonomikë. Këto Kontrata Tregtare do të gjykohen duke ndjekur proçedurat e prokurimit të Bankës Botërore duke patur patrasysh specifikat e Kredisë ndihmë Italiane.

1.3. Realizimi i kontratave të sipërpërmendura, do të vihet në jetë sipas një plani prokurimi, të konkorduar midis palëve, për sektorin elektrik.

1.4. Bihet dakort që Banka Agjente në lidhje me këtë Kredi Financiare do të jetë Filiali i (Romës) i San Paolo Imi.

1.5. Kredia Financiare do të jetë e disponueshme dhe e përdorshme në kohën, mënyrën dhe sipas kushteve të parashikuara në këtë Konventë Financiare, duke patur parasysh dispozitat (rregullat) në fuqi të Autoriteteve kompetente Italiane.

Neni 3
Hyrja në fuqi e Konventës Financiare;

3.1. Që kjo Konventë të hyjë në fuqi, Mediocredito Centrale duhet të marrë nga Huamarrësi dokumentet e mëposhtme:

1. Deklaratën e lëshuar nga organi kompetent i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, e cila vërteton caktimin e Ministrisë së Financave për të nënshkruar në emër dhe për llogari të Qeverisë Shqiptare, këtë Konventë Financiare nëpërmjet një personi të autorizuar, konform dispozitave legjislative, administrative dhe rregulloreve që janë në fuqi në Shqipëri, si dhe të marrë përsipër detyrimet që rrjedhin nga kjo Konventë; kjo deklaratë do të shoqërohet nga "depozitimi i firmës" të personit të autorizuar;

2. Aktin e caktimit, të lëshuar nga autoriteti kompetent i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, të personit ose personave të autorizuar për të firmosur Njohjen e Borxhit (Aneksi E) që parashikohet në Nenin 9 dhe dokumentet e tjera të parashikuara në këtë konventë, të cilat I bashkëngjiten në faksimile (Anekset A,B dhe C); ky akt duhet të japë në hollësi emrin dhe profesionin e këtyre personave dhe të shoqërohet nga "depozitimi" i firmave të tyre; Huamarrësi duhet t'ia dorëzojë këtë akt "depozitimin" e firmave, si dhe ndryshimet eventuale edhe Bankës Agjente.

3. Kopje të mandatit dhënë Bankës Agjente, për të hapur në emër të Huamarrësit një "Llogari me Jashtë" dhe për t'I përdorur fondet e akredituara eskluzivisht për të kryer pagesat e përcaktuara nga vetë Huamarrësi dhe sipas mënyrave të përcaktuara po nga ai; ky mandat duhet të hartohet në përputhje me Aneksin A, duhet të pranohet shprehimisht nga Banka Agjente dhe po kjo e fundit t'ia konfirmojë me shkrim Huamarrësit dhe për dijeni Mediocredito Centrale.

3.2. Hyrja në fuqi e kësaj Konvente Financiare është në varësi të nënshkrimit nga Autoritetet Shqiptare dhe ato Italiane i një Memorandumi teknik me të cilin do të përcaktohen modalitetet operative të Programit të Ndihmës.

3.3. Mediocredito Centrale, me marrjen e dokumenteve të përmendura më lart dhe pasi i ka

gjetur ato konform kërkesave të tij, i bën të ditur Huamarrësit, Bankës Italo-Shqiptare dhe Bankës Agjente, me anë të një letre ose telex-i i cili duhet të konfirmohet më pas me letër, datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

Neni 4
Afatet e përdorimit të kredisë.

4.1. Afati i përdorimit të Kredisë Financiare është 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente Financiare. Ky afat mund të zgjatet nga ana e Mediocredito Centrale, po jo përtej Periudhës së Qetësisë, me përjashtim të një komunikimi të kundërt nga ana e Huamarrësit i cili duhet të paraqitet brenda një muaji nga mbarimi i afatit.

4.2. Në rast se afati i përdorimit ka përfunduar dhe nuk është zgjatur, Mediocredito Centrale pasi ka marrë mendimin e Autoriteteve Kompetente Italiane i bën të ditur Huamarrësit dhe Bankës Italo-Shqiptare anullimin e detyrimit lidhur më fondet e papërdorura.

Neni 5
Mënyrat e përdorimit të Kredisë Financiare:

5.1. Kredia Financiare do të përdoret nga Huamarrësi në rast se do të përmbushen kushtet e mëposhtme :

(i) Dhënia e të drejtës nga ana e Autoriteteve Kompetente Italiane (Ministria e Punëve të Jashtme – Drejtoria e Përgjithshme e Kooperimit për Zhvillim) lidhur me përfshirjen e Kontratave Tregtare në Kredinë Finaciare;

(ii) Rezultati pozitiv i vëzhgimit në kompetencë të Mediocredito Centrale siç parashikohet në Nenin 5.2.

(iii) Marrja nga ana e Mediocredito Centrale e kërkesës për vënien në dispozicion të fondeve dhe të letrës udhëzuese Bankës Agjente siç parashikohet në Nenin 6.1 dhe 6.2.

5.2. Ne vijim të marrjes së të drejtës siç parashikohet në pikën (I), gjë e cila do i bëhet e ditur Huamarrësit dhe Bankës Italo-Shqiptare, Mediocredito Centrale fillon fazën vëzhguese që është kompetencë e saj e cila parashikon kontrolle në bazë të dispozitave të dhëna nga Autoritetet Kompetente Italiane, në lidhje me : a) eksportuesin Italian, b) ligjshmërinë e Kontratave Tregtare sipas kërkesave të Kredisë Financiare, c) kostot në lidhje me Kontratën Tregtare, me qëllim verifikimet që parashikohen në Nenin 7.6.

5.3. Përfundimi pozitiv I kësaj faze vëzhguese do të bëjë të mundur përfshirjen e Kontratave Tregtare në Kredinë Financiare. Financimi i Kontratave të mësipërme Tregtare do të përsoset vetëm pas marrjes së kërkesës dhe të letrës, siç parashikohet në Nenin 6.1 dhe 6.2.

5.4. Mediocredito Centrale do të vërë në dijeni Huamarrësin, Bankën Italo-Shqiptare, Bankën Agjente dhe eksportuesin italian lidhur me përfshirjen dhe përsosjen financiare të Kontratave Tregtare.

Neni 6
Kërkesa për akreditim fondesh

6.1. Menjëherë pas komunikimit për marrjen e lejes siç parashikohet në Nenin 5.1, Pika (i) Banka Italo-Shqiptare do t'i dërgojë Mediocredito Centrale një kërkesë për vënien në dispozicion të fondeve të nevojshme për të përballuar pagesat e parashikuara në çdo njërën nga Kontratat Tregtare. Me anën e kësaj kërkese, e cila hartohet në përputhje me Aneksin B), Huamarrësi njeh mundësinë e financimit dhe rregullsinë e Kontratave Tregtare dhe angazhohet t'i kthejë Mediocredito Centrale shumën që do të akordohet.

6.2. Banka Italo-Shqiptare do t'i dërgojë Bankës Agjente, për secilën nga Kontratat e mësipërme Tregtare, një letër udhëzuese hartuar në përputhje me Aneksin C), e cila duhet të pranohet shprehimisht nga Banka Agjente, e cila duhet t'ia komunikojë me shkrim Huamarrësit, Bankës Italo-Shqiptare dhe për dijeni Mediocredito Centrale.

6.3. Kërkesa dhe letra udhëzuese që parashikohen në Nenin 6.1 dhe 6.2 të kësaj Konvente duhet të mbërrijnë në kohën e duhur, por gjithsesi jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj nga data e njoftimit të Mediocredito Centrale. Me t'u kaluar ky afat, Mediocredito Centrale do të shqyrtojë, duke marrë

edhe mendimin e Autoriteteve Kompetente Italiane, shfuqizimin eventual të Kontratave Tregtare si zë i Kredisë Financiare.

6.4. Në bazë të udhëzimeve të mara nga Banka Italo-Shqiptare, siç parashikohen në Nenin 6.2 Banka Agjente do t'i kërkojë herë pas here Mediocredito Centrale, akreditimin në Llogarinë me Jashtë të fondeve të nevojshme për të kryer pagesat e parashikuara në Kontratat Tregtare, sipas modaliteteve të parashikuara në Nenin 7. Banka Agjente do të hartojë kërkesat e akreditimit konform Aneksit D) dhe do t'i dërgojë një kopje Huamarrësit dhe Bankës Italo-Shqiptare.

Neni 7

Mënyrat ë akreditimit të fondeve

7.1. Duke qënë gjithnje në fuqi afati i parashikuar në Nenin 4.1., secila kërkesë e pjesshme ose e plotë akreditimi (Neni 6.4) duhet t'i mbërrijë Mediocredito Centrale brenda dhe jo më shumë se 24 muaj nga komunikimi, siç parashikohet në Nenin 5.4 lidhur me përsosjen financiare të Kontratave Tregtare ose brenda afatit maksimal që parashikohet në vetë kontratat.

7.2. Secila nga kërkesat e akreditimit që parashikohet në Nenin 6.4 duhet të paraqitet në përputhje me çdo pagesë që duhet kryer, sipas mënyrave të parashikuara në secilën Kontratë Tregtare, me paraqitjen e Dokumentacionit Kontraktor.

7.3. Dokumentacioni Kontraktor do t'i dorëzohet Bankës Agjente nga eksportuesit italianë, e cila ia nis fotokopjet e njësuara me origjinalin Mediocredito Centrale dhe origjinalet Huamarrësit Bankës Italo-Shqiptare dhe PMU-së.

7.4. PMU, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e dërgimit të Dokumentacionit Kontraktor nga Banka Agjente, duhet t'i japë njoftim zyrtar kësaj banke agjente dhe për dijeni Bankës Italo-Shqiptare, rreth verifikimit ose në të kundërt në përputhje me furnizimin e të mirave dhe/ose shërbimeve për sa është treguar në Dokumentacionin Kontraktual relativ.

7.5. Pas mbarimit të 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, Banka Agjente do të konsiderojë automatikisht të njëjtë furnizimin e lartëpërmendur dhe do t'ia dërgojë Mediocredito Centrale, dhe per dijeni Huamarrësit dhe Bankës Italo-Shqiptare, kërkesën relative të akreditos.

7.6. Kohët e fundit pas marrjes së ndonjërës prej kërkesave të akreditos, Mediocredito Centrale do të procedojë me verifikimin e Dokumentacionit Kontraktual. Ky verifikim i përket përputhjes me këtë Dokumentacion Kontraktual të Kontratës Tregtare përkatëse.

7.7. Mediocredito Centrale do t'i ekzekutojë kërkesat e mësipërme të akreditimit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së tyre.

7.8. Në varësi të përfundimit pozitiv të verifikimit që parashikohet në Nenin 7.6, Mediocredito Centrale do t'i japë Bankës Agjente udhëzimet e nevojshme për akreditimin e fondeve në Llogarinë me Jashtë dhe do t'i konfirmojë me teleks ose faks Huamarrësit dhe Bankës Italo-Shqiptare shumën totale dhe monedhën e akreditimit.

7.9. Në të njëjtën kohë me akreditimin në Llogarinë me Jashtë, Banka Agjente do t'u kryejë pagesat eksportuesëve italianë sipas udhëzimeve të dhëna, duke marrë Deklaratën e pagesës që parashikohet në Aneksin F) në dy kopje origjinale, një nga të cilat do t'i dërgohet Bankës Italo-Shqiptare dhe tjetra Mediocredito Centrale.

7.10. Pas çdo akreditimi fondesh në Llogarinë me Jashtë dhe kryerjen e pagesave përkatëse eksportuesve të mësipërm, Mediocredito Centrale do t'i dërgojë me letër Huamarrësit dhe Bankës Italo-Shqiptare dhe Bankës Agjente për dijeni, planin e shlyerjes së shumës së akorduar me përcaktimin e mbarimit të afateve përkatëse siç është parashikuar në Nenin 8. Banka Italo-Shqiptare do të konfirmojë më shkrim pranimin e këtij plani shlyerje.

Neni 8

Kthimi i kredisë dhe pagimi i interesave

8.1. Çdo shumë e akredituar në "Llogarinë e Jashtme" do të kthehet në bazë të një plani shlyerje prej 26 (njëzet e gjashtë) këstesh gjashtëmujore, të barabartë dhe të njëpasnjëshëm (kuota kapitali), ku pagesa e kështit të parë skadon 330 (treqind e tridhjetë) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Konvente Financiare. Mediocreditocentrale do t'i dërgojë planin e shlyerjes Huamarrësit/Bankës Italo-Shqiptare dhe Bankës Agjente për dijeni siç është parashikuar në Nenin 7.10.

8.2. Mbi kuotat kapital (këstet) të çdo kreditimi në "Llogarinë me Jashtë" do të llogariten interesa në masën 0,25 % (zero presje njëzet e pesë për qind) në vit të barabarta me 0,125 % (zero presje njëqind e njëzet e pese për qind) në fund të gjashtëmujorit, duke filluar nga data e kreditimit dhe deri në datën e kthimit të kuotës së fundit të kapitalit. Interesat do të llogariten në bazë muaji 30 (tridhjetë) ditësh dhe viti 360 (treqind e gjashtëdhjetë) ditësh (360/360).

8.3. Gjatë periudhës së kthimit, këto interesa do të paguhen në të njëjtën datë skadence me Kuotat kapital. Gjatë periudhës së aktivitetit zero (Periudhës së Qetësisë), këto interesa do të paguhen në bazë gjatëmujori në datat qe u korrespondojnë me ditë dhe muaj datave të pagimit të Kuotave të Kapitalit. Në këtë mënyrë, kuota e parë e interesit mund të përkojë me një periudhë më të shkurtër se gjashtëmujori. Megjithatë në rast se kjo periudhë është më e shkurtër se 30 (tridhjetë) ditë, kjo kuotë interesi do të paguhet me kuotën e mëpasshme të interesit. Kuota e parë e interesit, që i përket një periudhe më të gjatë ose më të shkurtër se gjashtëmujori, do të llogaritet për ditët që efektivisht kanë kaluar nga data e akreditimit në "Llogarinë e Jashtme" në datën e pagesës, në bazë të një gjashtëmujori prej 180 ditësh.

8.4. Deri në datën e lëshimit të Njohjes së Borxhit (Neni 9) pagesa e interesave që lidhen me çdo përdorim do të bëhet në afatet e parashikuara në planet e shlyerjes (Neni 7.10); menjëherë pas kësaj date kthimi i kapitalit dhe pagimi i interesave do të bëhet në afatet e parashikuara në planin e shlyerjes të Njohjes së mësipërme të Borxhit.

8.5. Për të gjitha shlyerjet dhe pagesat që duhet të bëhen në bazë të kësaj Konvente Financiare dhe në bazë të Deklaratës përkatëse të Borxhit, Huamarrësi ka detyrimin të bëjë në kohën e duhur arkëtimin e shumës përkatëse në lireta italiane në favor të Mediocredito Centrale ose të ngarkuarve të saj pranë Bankës Agjente. Këto shuma do të akreditohen pa asnjë zbritje të detyrimeve bankare dhe/ose valutore dhe fiskale dhe pa qenë nevoja e paralajmërimit nga ana e Mediocredito Centrale ose të ngarkuarve të saj.

Neni 9

Lëshimi i Deklaratës së Njohjes së Borxhit

9.1. Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga afati i fundit për përdorimin e kredisë (Neni 4.1.), Huamarrësi do t'i lëshojë Mediocredito Centrale Deklaratën e Njohjes së Borxhit, të firmosur në çdo faqe, të hartuar në përputhje me Aneksin E).

9.2. Kjo deklaratë e njohjes së Borxhit është lirisht e transferueshme nga Mediocredito Centrale tek persona juridikë publikë ose privatë, italianë apo të huaj. Është e qartë se Huamarresit nuk mund t`i ngarkohen detyrimet për shpenzimet, komisionet, taksat ose tatimet që mund të rrjedhin nga lëshimi eventual i Deklaratës së Njohjes së Borxhit. Mediocredito Centrale tek persona juridikë publikë ose privatë, italianë apo të huaj.

9.3. Plani i shlyerjes së kësteve i risjellë në Deklaratën e Njohjes së Borxhit do të hartohet duke mbledhur kuotat kapital dhe interesat që nuk u ka mbaruar ende afati dhe këstet që mund t'u ketë kaluar afati, por që nuk janë paguar në datën e lëshimit të Deklaratës së Njohjes së Borxhit, të cilat rezultojnë nga planet e veçanta të shlyerjes të përgatitura për çdo përdorim siç përdorim siç është parashikuar në Nenin 7.10.

9.4. Mediocredito Centrale do të depozitojë deklaratën e njohjes së Borxhit për ruajtje dhe administrim pranë Bankës Agjente, pas aprovimit të xhirimit në favor të saj.

9.5. Banka Agjente do të regjistrojë herë pas here në Deklaratën e njohjes së Borxhit pagesat e shumave të kapitaleve dhe interesave dhe këstet që u ka kaluar afati dhe që nuk janë paguar. Me t`u kryer të gjitha pagesat e parashikuara në Deklaratën e Njohjes së Borxhit, Banka Agjente duhej t`ia kthejë këtë të fundit Huamarrësit kundrejt mandatit përkatës.

Neni 10

Detyrimet e huamarrësit

10.1. Angazhimi i Huamarrësit për të kryer pagesën e shumave në bazë të kësaj Konvente Financiare dhe Deklaratës relative të Njohjes së Borxhit është autonome, absolute, e pakushtëzuar dhe e parevokueshme.

Neni 11
Raste të pezullimit të punës

11.1. Mediocredito centrale gjatë periudhës së vënies në punë të Kredisë Financiare rezervohet të pezullojë furnizimin duke mos i dhënë rrugë të lirë kërksave të arkëtimit në bazë të nenit 6, që rezultojnë shkelje në lidhje me Mediocredito Centrale në bazë të kësaj Konvente Financiare ose të kredive të tjera financiare të dhëna nga vete Mediocredito Centrale Qeverisë ose Bankës Qendrore ose Enteve të Shtetit të Republikës së Shqipërisë, në bazë të Nenit 6 të ligjit italian n.38 të shkurtit 1979 dhe të Nenit 6 të ligjit Italian n.49 të 26 shkurtit 1987 dhe modifikime pasuese. Mediocredito Centrale do të japë komunikim të menjëhershëm për pezullimin ndaj Huamarrësit dhe Bankës Italo-Shqiptare.

11.2. Në rastin kur Banka Agjente ballafaqohet me pengesë që, për motive të pavarura nga vullneti i saj, nuk e lejojnë, t'i japë rrugë instruksioneve të akreditimit nga ana e Mediocredito Centrale në Llogarinë me Jashte shih Neni 7.8, e njëjta Bankë Agjente do t'i japë komunikim të menjëhershëm me shkrim Huamarrësit dhe vete Mediocredito Centrale. Në momentin e zhdukjes se këtyre pengesave, Banka Agjente do t`i japë rrugë, duke u lidhur me Mediocredito Centrale, instruksioneve të akreditimit të marra fillimisht nga vetë Mediocredito Centrale.

11.3. Mediocredito Centrale nuk do t`i japë rrugë kërkesave të akreditimit Neni 6.4. në rast se nuk janë të disponueshme shumat nga nga e Autoriteteve Kompetente Italiane.

Neni 12
Kamatëvonesë

12.1. Në rast se për një arsye çfarëdo, për të cilën nuk është përgjegjës Huamarrësi, shumat e kapitalit dhe të interesave nuk kthehen brenda afatit në Bankën Agjente brenda datës së skadimit, Huamarrësi është i detyruar të paguajë kamatëvonesat e këtyre shumave për periudhën midis datës së mbarimit të afatit dhe datës së akreditimit efektiv në favor të Mediocredito Centrale ose të ngarkuarve ligjorë pranë vetë Bankës Agjente.

12.2. Këto kamatëvonesa do të llogariten në masë 0.25 % (zero njëzet e pesë për qind) për 35 (tridhjetë e pesë) ditët e mëpasshme nga data e mbarimit të afatit fillestar dhe menjëherë më pas, në masë 5 % (pesë përqind) deri në datën e pagesës efektive në Mediocredito Centrale.

12.3. Për 35 (tridhjetë e pesë) ditët menjëherë të mëpasshme nga data e mbarimit të afatit fillestar, këto kamatëvonesa do të llogariten gjithnjë me regjimet e interesave të thjeshta; për periudhën e mëpasshme ato do të llogariten me regjimet e interesit të thjeshtë, kur kjo periudhë është më e vogël se një vit, dhe me regjimin e interesit të kombinuar, kur kjo periudhë është më e madhe se një vit.

Neni 13
Rimbursim i kuotave të financimit në rast mosrealizimi të Programit të Ndihmës

13.1. Në rast mungese apo realizimi të pjesshëm të Programit të ndihmës, Huamarrësi do të rimbursohet edhe për kuotat e lëvruara si parapagim, në bazë të kushteve të përcaktuara me Komponentët e Autoriteteve Italiane.

Neni 14
Detyrimet tatimore

14.1. Në bazë të nenit 9.2 të mësipërm, çdo detyrim tatimor, aktual apo i ardhshëm për çfarëdolloj detyrimi në Shqipëri, në varësi të Marrëveshjes Financiare në fuqi dhe të Deklaratës së Borxhit relative me të, do të jetë ekskluzivisht në ngarkim të Huamarrësit.

14.2. Çdo detyrim tatimor në Itali, në varësi të Konventës Financiare nuk do të jetë në ngarkim të Huamarrësit.

14.3. Mediocredito Centrale deklaron se do të përdorë regjimin fiskal në nenin 19 të D.P.R. n. 601 të 29 shtatorit 1973 dhe ndryshimet e mëvonshme.

Neni 15
Ligji i zbatueshëm

15.1. Kjo Konventë Financiare është hartuar në bazë të ligjit italian.

Neni 16
Mosmarrëveshje të mundshme

16.1.Palët do të përpiqen të zgjidhin miqësisht çdo lloj mosmarrëveshje që vjen nga interpretimi dhe/ose zbatimi i kësaj Konvente Financiare.

16.2. Në rast se përpjekje të tilla, brenda një kohe të arsyeshme nuk do të çonin në zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve, këto do të zgjidhen në nivel qeveritar.

16.3. Në rast se një përpjekje e tillë nuk do të bëhej (ose do të bëhej) por nuk do të çonte në një zgjidhje të kënaqshme, të gjitha mosmarrëveshjet që vijnë nga kjo Konventë Financiare apo kanë lidhje me të do të zgjidhen përfundimisht sipas Rregullores së Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris, Francë, nga një Trup arbitror i përbërë nga tre anëtarë:

- një i caktuar nga huamarrësi
- një i caktuar nga Mediocredito Centrale
- një i caktuar nga arbitrat e mësipërm ose, në rast mosmarrëveshjesh, nga Presidenti i Dhomës se Tregtise Ndërkombëtare të Parisit.

16.4. Në rast se Huamarrësi ose Mediocredito Centrale nuk kanë caktuar arbitrin e tyre brenda 30 ditëve duke filluar nga kërkesa e palës tjetër, arbitri do të caktohet nga Presidenti i Dhomës së Tregtise Ndërkombëtare në Paris.

16.5. Vendimi i Trupit Arbitror, i cili do gjykojë sipas ligjit Italian, do të jetë përfundimtar dhe i parevokueshëm.

16.6. Pavarësisht nga çdo mosmarreveshje që mund të lindë mes palëve Huamarrësi duhet të paguajë në afatet e caktuara, të gjitha shumat në varësi të kësaj Konvente Financiare dhe në veçanti të gjitha shumat që rrjedhin nga planet për shlyerje (neni 8) dhe nga Deklarata e Borxhit në vijim.

Neni 17
Njoftime

17.1. Çdo njoftim që duhet zbatuar në lidhje me këtë Konventë Financiare duhet të drejtohet në adresat e mëposhtme:

-HUAMARRËSI:……..:
-BANKA ITALO-SHQIPTARE:……:
-MEDIOCREDITO CENTRALE-Via Piemonte 51, 00187 Roma-ITALIA- n.telex 626496/626497
-n. swift MCENITRR;
- Servizio Credito Estero-Ufficio Istruttoria Convenzioni Finanziarie:
- N.tel. 0039 6 4791592 – n. fax 0039 6 4791574:
- Servizio Amministrazione – Uffico Erogazione: n. tel 0039 6 4791380 – n. fax.0039 6 4791059; Ufficio Rientri: n.tel. 0039 6 4791438 – n.fax 0039 6 4791758
- BANKA AGJENTË:……

Neni 18
Origjinalet e Konventës Financiare

18.1. Kjo Konventë Financiare është hartuar dhe nënshkruar në katër origjinalë në gjuhën italiane dhe në katër origjinale në gjuhën angleze prioritare, në raste mosmarrëveshjesh, teksti i hartuar në gjuhën italiane.

Palët kanë nënshkruar Konventën Financiare në ditën dhe vendin e treguar.

Mediocredito Centrale S.p.A
Francesko Anania

Për Qeverinë e Republikën e Shqipërisë
Anastas Angjeli

Firmosur në Tiranë më 11 maj 2000

L I G J
Nr.8622, datë 14.6.2000

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE EKSPORTFINANS-ËS (ASA)"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e huasë ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Eksportfinans-ës (ASA)".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2661, datë 19.6.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

MARRËVESHJE HUAJE E LIDHUR NË DATË 28.4.2000 MIDIS REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËRFAQËSUAR NGA QEVERIA E SHQIPËRISË (MË POSHTË QUAJTUR HUAMARRËSI) DHE EKSPORTFINANS ASA, OSLO, NORVEGJI (MË POSHTË REFERUAR EKSPORTFINANS)

H Y R J E

Ndërsa Jakobsen Elektro (Ofruesi) dhe Korporata Elektro-Energjetike Shqiptare (KESH) (Blerësi) në 24 mars 2000 lidhën një kontratë (kontrata) për projektin: furnizimi dhe instalimi i bokseve metalike kolektive;

Ndërsa Eksportfinans i ka shprehur Ministrisë së Financave të RSh për këtë financim;

Ndërsa Eksportfinans ka vendosur financimin e kontratës së mësipërme me termat dhe kushtet e vendosura në këtë marrëveshje;

tani më poshtë bihet dakord mes palëve si vijon:

Neni 1
Përcaktime

1.1. Në këtë Marrëveshje:

Llogari - nënkupton llogarinë e Eksportfinansit no. 36988196 në Citibank NA, New York (wall street) në të cilën do të bëhen pagesat nga Huamarrësi sipas kësaj marrëveshjeje

Paradhënie - nënkupton çdo shumë të Lehtësisë që është disbursuar në bazë të kësaj marrëveshjeje.

Marrëveshja e Agjentit - nënkupton autorizimin me shkrim të Huamarrësit drejtuar bankës agjente që do të veprojë në emër të saj.

Banka agjente - është Den Norske Bank, Oslo, Norvegji, e emëruar për të vepruar në emër të Huamarrësit sipas kësaj marrëveshjeje.

Marrëveshja - nënkupton këtë marrëveshje huaje me anekset siç mund të ndryshohen kohë pas kohe.

Ditët e punës - janë ditët në të cilat bankat janë të hapura për punë në Oslo, Londër e New York dhe vende të tjera siç mund t'i duhet Eksportfinansit për të kryer transaksionet sipas kësaj marrëveshjeje.

Pjesa Cash - është diferenca midis (pjesës përkatëse të) Shumës së Kontratës dhe (pjesës korresponduese të) Lehtësisë siç përcaktohet më poshtë.

Data e konsolidimit - është data jo më vonë se 31 mars 2002 në të cilën të gjitha paradhëniet dhe interesi i akumuluar gjatë periudhës së tërheqjeve do t'i shtohet dhe përbëjë Huanë.

Shuma e Kontratës - është detyrimi final dhe total sipas Kontratës siç mund të ndryshohet kohë pas kohe.

Polica e Sigurimit të Kredisë - është polica e sigurimit të kredisë lëshuar nga GIEK.

Data e disbursimit - është data e disbursimeve aktuale sipas kësaj marrëveshjeje (kjo duhet të jetë ditë pune).

Skeduli i disbursimit - është skeduli që tregon datën e pritshme për disbursimet, datën më të fundit të mundshme të pagesës së Pjesës në Cash ose pjesë të saj dhe datat e kërkuara për disbursime nga Eksportfinans, disbursim që do të bëhet nga Eksportfinans një ditë pune në ose pas livrimit përkatës.

Periudha e tërheqjeve - është periudha që nga disbursimi i parë deri në datën e konsolidimit, gjatë së cilës do të bëhen të gjitha Paradhëniet.

Lehtësia - është më e vogla nga (1) 85 % të shumës së kontratës dhe (2) 9.775.999 USD.

GIEK - është Instituti Norvegjez i Garantimit për Kreditë e Eksportit.

Primi i Garancisë së GIEK-un - është pagesa për GIEK-ut për lëshimin e Policës së Sigurimit të Kredisë.

Garancia - është një garanci pa kusht dhe e parevokueshme e disponueshme mbi bazën e kërkesës, lëshuar nga Garantuesi në favor të Eksportfinans që mbulon të gjitha shumat e pagueshme nga Huamarrësi sipas kësaj marrëveshjeje.

Garantuesi - është një bankë e pranueshme për Eksportfinansin vetëm sipas mendimit të saj.

LIBOR - është Përqindja e interesit e Ofruar Ndërbankare e Londrës për dollarin siç përcaktohet nga Eksportfinans për shumën përkatëse dhe periudhën në tregun e LIBOR-it rreth orës 11 në mëngjes të Londrës 2 ditë pune përpara se të fillojë periudha përkatëse, e rrumbullakosur lart në 1/16. Nëse nuk ka kuota në dispozicion siç u tha më lart, një përqindje alternative e arsyeshme do të vendoset nga Eksportfinans.

Hua - nënkupton totalin e të gjithë paradhënieve, plus interesin e akumuluar gjatë periudhës së tërheqjeve, nga koha në kohë të papaguara sipas kësaj marrëveshjeje.

Notë premtuese - është një dokument i dhënë në Aneksin 1 dhe 2 të kësaj marrëveshjeje e nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar i Huamarrësit.

USD - është monedha në fuqi e SHBA.

Neni 2
Huaja dhe përdorimi i saj

2.1. Sipas kushteve dhe termave të dhëna në këtë marreveshje, Eksportfinans bie dakord t'i japë një lehtësi Huamarrësit për qëllimin e ri-huadhënies së saj KESH-it. Lehtësia nuk mund të përdoret për qëllime të tjera.

2.2. Nëse, për ndonjë arsye, Shuma e Kontratës është zvogëluar pasi është i bërë disbursimi nga Eksportfinans Ofruesit, shuma e disbursuar që kalon Lehtësinë, bashkë me interesin, do të bëhet menjëherë e detyrueshme për t'iu paguar Eksportfinansit nga Huamarrësi.

Neni 3
Kushte paraprake

3.1. Detyrimet e Eksportfinans për të disbursuar sipas kësaj marrëveshjeje janë, interalia, të varura nga plotësimi i kushteve të mëposhtme paraprake: jo më vonë se 12 javë pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, Eksportfinans duhet të ketë marrë në formë të kënaqëshme për të:

a) një kopje të vërtetuar të përkthimit në anglisht të aprovimit përfundimtar të Këshillit të Ministrave të RSH të kësaj marrëveshjeje dhe dokumentet e lidhur me të në emër të RSH;

b) një kopje të vërtetuar të përkthimit në anglisht të Plotfuqisë, të nënshkruar nga Ministri i Punëve të Jashtme dhe Kryeministri që autorizon Ministrin e Financave për të nënshkruar marrëveshjen dhe ndonjë dokument të lëshuar dhe specimenet e firmave;

c) një kopje të vërtetuar dhe përkthimin në anglisht të ratifikimit të huasë nga Parlamenti i RSH;

d) një kopje të vërtetuar të publikimit të ratifikimit të referuar në pikën c) më sipër;

e) Polica e Sigurimit të Kredisë nga GIEK dhe Garancia nga Garantuesi, të dyja të lëshuara siç duhet janë në fuqi të plotë;

f) Skeduli i Disbursimeve;

g) opinion ligjor nga Ministri i Drejtësisë të RSH në formë të kënaqshme për Eksportfinans dhe

gj) një opinion ligjor të dhënë nga një jurist i zgjedhur nga Eskportfinans.

3.2. Me marrjen e dokumenteve te mësipërm, Eksportfinans brënda 10 ditëve pune do të lajmërojë Huamarrësin nëse e konsideron pikën 3.1 të përmbushur.

3.3. Detyrimet e Eksportfinans sipas kësaj marrëveshjeje varen edhe nga:

(a) nuk do të ketë ndodhur ndonjë ndryshim në kushtet kombëtare, ndëkombëtare, financiare, politike ose ekonomike, ose kontrollin e këmbimit të monedhës siç mund të prekin materialisht disbursimin sipas mendimit të saj, dhe duke i dhënë lajmërimin Huamarrësit, Eksportfinans do të jetë e lirë nga detyrimet sipas kësaj marrëveshjeje ; dhe

(b) Garancia dhe Polica e Sigurimit te Kredisë në seksionin 3.1 (e) janë në fuqi në çdo kohë.

Neni 4
Disbursimi

4.1. Me kusht që Kushtet Paraprake të dhëna në nenin III janë përmbushur siç duhet dhe Eksportfinans të ketë marrë :

a) kërkesën e disbursimit nga Banka agjente 15 ditë para datës së disbursimit;

b) konfirmimin nga banka agjente që pjesa në Cash është paguar;

c) konfirmimin nga banka agjente që është livruar Kontrata në përputhje me Skedulin e Disbursimit;

d) konfirmimin nga banka agjente që të gjitha komisionet e të gjitha pagesat të ngarkuara nga GIEK dhe Garantuesi ose komisione të tjera janë paguar para datës së disbursimit

e) konfirmimin nga banka agjente që banka agjente ka marrë notat premtuese të rëna dakord;

Banka agjente do të :

f) vendosë në notën premtuese vendin dhe datën e lëshimit dhe kjo do të koincidojë me datën e disbursimit nga Eksportfinans, shumën dhe datën e maturimit.

g) do t'ia dërgojë Notat Premtuese të dhëna Eksportfinans dhe pastaj Eksportfinans do të bëjë disbursimin për Ofruesin.

Neni 5
Interesi

5.1. Huamarrësi merr pësipër t'i paguajë Eksportfinans në përqindjen e LIBOR – it + 0,50 në vit.

5.2. Gjatë periudhës së tërheqjeve do të rrjedhë interes dhe do të llogaritet me periudha gjysëm vjetore, 85 % e të cilave do të akumulohen dhe shtohen shumës totale të principalit çdo 6 muaj në datën e konsolidimit. Mbetja prej 15 % e interesit të rrjedhur të llogaritur në çdo Paradhënie do të paguhet për herë të parë 6 muaj pas datës së disbursimit, në datat që bien çdo shumëfish të 6 muajve dhe në datën e konsolidimit.

Nëse dhe atëherë kur shuma e akumuluar e interesit arrin 680,000 USD Huamarrësi do të

paguajë interes mbi këtë përqindje për pjesën e mbetur të periudhës së tërheqjeve.

5.3. Pas datës së konsolidimit interesi do të paguhet çdo 6 muaj, herën e parë 6 muaj pas datës së konsolidimit.

5.4. Në ndonjë rast, për ndonjë arsye, të vonesës në pagesë në Llogari të detyrimeve të Huamarrësit sipas kësaj marrëveshjeje Huamarrësi do të paguaj interes mbi këtë shumë në përqindjen e 6 muajve të LIBOR-it per USD + 0,300, e përbërë mbi bazë mujore, nga data e caktuar deri në datën aktuale të pagesës dhe do të paguhet bashkë me shumën e papaguar.

5.5. Interesi dhe interes-vonesa do të llogaritet mbi bazën e ditëve aktuale të llogaritura dhe me vitin 360 ditë.

Neni 6
Shlyerja

6.1. Huamarrësi do ta shlyejë huanë në 20 këste të barabarta 6- mujore, për herë të parë 6 muaj pas datës së konsolidimit.

Neni 7
Parapagimi

7.1. Eksportfinans me kërkesë dhe sipas mendimit të saj mund të bjerë dakord me shlyerjen në tërësi por jo me pjesë të huasë, nëse rrethanat lejojnë dhe duke bërë kompesimin e plotë të kostove, shpenzimeve dhe humbjes së të ardhurave nga interesi.

Neni 8
Pagesat

8.1. Të gjithë pagesat e principalit, interesit dhe shumave të tjera të pagueshme më poshtë do të bëhen me vlerën e datave respektive në USD në Llogari pa lajmërim paraprak Eksportfinans.

Në se data e detyrimit nuk është ditë pune në vendin e pagesës, pagesa do të bëhet në ditën pasardhëse të punës. Sidoqoftë nëse kjo ditë bie në muajin tjetër , pagesa do të bëhet të paktën në ditën paraardhëse të punës.

Vendi i pagesës mund të ndryshohet me 10 ditë pune lajmërim me shkrim Huamarrësit.

8.2. Huamarrësi bie dakord të paguajë të gjitha shumat e detyruara sipas kësaj marrëveshjeje plotësisht dhe bie dakord të mos ketë të drejtë të zbresë ndonjë shumë që detyrohet ose pretendohet të zotërohet nga Eksportfinans nga shuma që i detyrohet Eksportfinans dhe bie dakort të mos ngrejë ndonjë kundërpretendim për çfarëdo arsye. Huamarrësi gjithashtu bie dakord të mos pengojë pagesën e shumave të detyruara. Eksportfinans sipas kësaj marrëveshjeje për arsye kur ai ose KESH kanë ndonjë pretendim, të drejtë Padie, ose kërkesë kundrejtë Ofruesit ose ndonjë pale të tretë.

8.3. Të gjithë pagesat do të jenë të lira nga ndonjë kufizim ose kusht dhe pa zbritje taksash, shpenzime ose detyrime të ndonjë natyre. Nëse kërkohet të bëhen këto zbritje Huamarrësi do të paguajë ndonjë shume shtesë që mund të ishte e nevojshme sipas kësaj marrëveshjeje në mënyrë që Eksporfinans të marrë të gjitha shumat e detyrueshme

Neni 9
Kosto dhe shpenzimet

9.1. Ndonjë detyrim për pulla, komisione ose taksa të tanishme ose të ardhme të pagueshme në lidhje me ekzekutimin, livrimin, regjistrimin e kësaj marrëveshjeje do të jenë përgjegjësi e Huamarrësit.

9.2. Ndonje kosto për Policën e Sigurimit te Kredisë dhe Garancinë , duke përfshirë por jo duke u kufizuar vetëm në primin e GIEK-ut dhe komisionin për Garantuesin do të jetë përgjegjësi e Huamarrësit. 85 % e primit të GIEK-ut dhe komisionin për Garantuesin do të financohet në mënyrë që shuma e aplikueshme t'i shtohet huasë në çdo datë disbursimi.

9.3. Ndonjë kosto për shërbimet ligjore, duke përfshirë prokurimin dhe ekzekutimin e

opinionit ligjor të kërkuar në Seksionin 3.1 (g) do të jenë për llogari të Huamarrësit. 85 % e kostos në lidhje me këto shërbime, megjithatë e kufizuar në 20.000 USD do të financohet me kredi , kështu që shuma e aplikuar do t'i shtohet huasë në datën e marrjes së faturës nga konsulenti ligjor i jashtëm i Eksportfinans.

9.4. Të gjitha kostot në lidhje me Marveshjen e agjentit do të shkojnë për llogari te Huamarrësit . 85 % e komisionit të bankës agjente do të financohet me kredi , kështu që kjo shumë do t'i shtohet Huasë në datën e disbursimit.

9.5. Huamarrësi do të rimbursojë Eksportfinans për të gjithë shpenzimet e tjera në lidhje me këtë marrëveshje duke përfshirë shpenzimet e lidhura me përgatitjen e dokumentacionit dhe shpenzime xhepi ose udhëtimi.

Rimbursimi do të bëhet 30 ditë pas datës së faturës.

Neni 10

Notat premtuese

10.1. Huamarrësi do t'i japë bankës agjente Nota Premtuese në numrin e kërkuar për të evidentuar çdo detyrim të huamarrësit për pagesën e principalit deri në datën e konsolidimit dhe interesit gjatë periudhës nga dhe duke përfshirë datën përkatësë të disbursimit dhe duke përjashtuar datën e konsolidimit. Notat Premtuese do të jepen Eksportfinans në përputhje me nenin IV , 4.1 (g).

10.2. Notat Premtuese të lëshuara në lidhje me disbursimet në periudhën e tërheqjeve që evidentojnë detyrimin e Huamarrësit për pagesën e principalit dhe interesit do të maturohen në datën e konsolidimit.

Përveç kur ka ndodhur ndonjë shkelje e marrëveshjes dhe ajo është në vazhdim, 20 Nota te tjera Premtuese që evidentojnë pagesat e principalit dhe interesit do të lëshohen nga Huamarrësi. Këto Nota Premtuese do të maturohen në secilën prej datave të detyrimit të principalit dhe interesit, hera e parë do t'i bierë 6 muaj pas datës së konsolidimit dhe më pas çdo 6 muaj dhe do të këmbehet nga Notat Premtuese që maturohen në Datën e Konsolidimit dhe do t'i dërgohen bankës agjente jo më vonë se 20 ditë pune para datës së konsolidimit.

10.3. Të gjitha Notat Premtuese të lëshuara do të jenë të bardha përsa i përketë shumës,datës së maturimit dhe datës dhe vendit të lëshimit.

10.4. Kur ekzekutohet, Nota Premtuese, në përputhje me ligjin Norvegjez që rregullon instrumentat e negociueshme të borxhit do të përbëjë detyrimin e pakushtëzuar dhe të parevokueshëm të Huamarrësit si i detyruar direkt për të paguar shumën që jepet në termat e rëna dakord dhe ky detyrim nuk do të preket në asnjë mënyrë nga ndonjë mosmarrëveshje, pretendim apo kundërpretendim.

Neni 11

Përfaqësimi dhe vërtetimet; Marrja përsipër

11.1. Përfaqësimi dhe certifikatat

Huamarrësi i jep prezantimet dhe vërtetimet Eksportfinans:

(a) është brenda pushtetit të tij të hyjë në këtë marrëveshje, të marrë hua dhe të marrë përsipër detyrimet, të autorizojë ekzekutimin, livrimin e kësaj marrëveshjeje dhe ndonjë marrëveshjeje ose instrumenti tjetër të kërkuar.

(b) Kjo marrëveshje përbën detyrim ligjërisht të vlefshëm, direkt dhe pa kushte për Huamarrësin të shtrëngueshëm në përputhje me termat e saj.

(c) Ndonjë ratifikim nga parlamenti, autorizimet, aprovimet, licencat, aprovimet ose perjashtimet të ndonjë rregjistrimi të marrëveshjes ose ndonjë dokumenti tjetër me autoritet qeveritar ose rregullator, zyrë ose agjenci në RSH të kërkuar në lidhje me ekzekutimin, livrimin ose vlefshmërinë e kësaj marrëveshjeje, Kontratës ose ndonjë marrëveshje ose instrumenti tjetër të kërkuar është shikuar dhe livruar Eksportfinans dhe janë në fuqi të plotë dhe ndonjë kusht që jepet atje ose i aplikueshëm për shkaqe të tjera është ose do të përmbushet në kohën e caktuar gjatë jetës së kësaj marrëveshjeje .

(d) Ekzekutimi, livrimi i kësaj marrëveshjeje, notave premtuese dhe ndonjë marrëveshje tjetër ose dokumenti nuk do të kalojnë pushtetin e dhënë Huamarrësit, ose shkelin ndonjë amendament ose

përjashtim të dispozitave të:

(i) ndonjë ligji, rregulloreje, urdhëri, dekreti ose ratifikimi nga parlamenti ose ndonjë autoriteti qeveritar, agjenci, gjykatë ndaj të cilave Huamarrësi është i varur.

(ii) ndonjë rezolutë të Huamarrësit

(iii) ndonjë traktati, marrëveshje, instrumenti ose detyrimi të detyrueshëm për Huamarrësin dhe

(a) nuk është në shkelje të ndonjë marrëveshjeje ndaj së cilës ajo është palë ose mund të jetë e lidhur dhe nuk ka ndonjë procedim për sa është në dijeni Huamarrësi, të cilat mund të kenë efekt material në gjendjen e tij financiare dhe aftësinë për të përmbushur detyrimet sipas kësaj marrëveshjeje.

11.2. Marrja përsipër

Huamarrësi merr përsipër dhe bie dakord që sa kohë që mbetet ndonjë shumë e papaguar principali ose interesi për Huanë ose ndryshe sipas kësaj marrëveshjeje :

(i) Huamarrësi do t'i dërgojë Eksportfinans informacion në lidhje me marrëveshjen ose situatën financiare të Huamarrësit siç Eksportfinans mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme;

(ii) huamarrësi do të bëjë të gjithë veprimet ose gjërat që do të kërkohen në lidhje me kryerjen e të gjithë detyrimeve të kësaj marrëveshjeje .

(iii) Huamarrësi do të përdorë të gjithë mundësitë e tij per të bërë të mundur që pagesa e principalit dhe interesit të Huasë përfshihet në buxhetin e Huamarrësit mbi baza vjetore.

a) Huamarrësi dhe Eksportfinans do të informojnë menjëherë njëri-tjetrin për ndonjë kusht ngjarje ose veprim që ndërhyn ose kërcënon të ndërhyjë në implementimin e detyrimeve përkatëse sipas kësaj marrëveshjeje .

Neni 12

Banka Agjente

12.1. Huamarrësi do të emërojë bankën agjente për të vepruar në emër të saj mbi bazën e një marrëveshje agjencie. Marrëveshja e Agjencisë duhet të miratohet nga Eksportfinans dhe do të përfshijë sa më poshtë:

a) autorizimin e bankës agjente per t'i kërkuar Eksportfinas në mënyrë të parevokueshme në emër të huamarrësit për të bërë disbursim me 15 ditë njoftim përpara disbursimit të skeduluar;

b) autorizimin e bankës agjente për të mbushur notat premtuese me një shumë, datë dhe vend të lëshimit dhe datën e maturimit në ditën që këto detaje do të bëhen të ditura.

12.2. Marrëveshja e agjencisë nuk do të ndryshohet ose mbarojë pa miratimin paraprak nga Eksportfinans dhe do të mbetet në fuqi derisa të gjithë shumat të jenë shlyer sipas kësaj marrëveshjeje .

Neni 13
Ngjarjet që përbëjnë shkelje

13.1. Nëse ndonjë nga ngjarjet e mëposhtme do të ndodhë Eksportfinans me vendimin e saj të lirë mund t'i japë fund ndonjë prej detyrimeve të tij dhe mund të deklarojë që huaja të bëhet menjëherë për t'u paguar bashkë me interesin e rrjedhur dhe të gjitha shumat për t'u paguar, konkretisht:

a) Huamarrësi nuk paguan në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje ndonjë këst, ose interes ose ndonjë shumë tjetër për t'u paguar dhe ky dështim nëse është teknik nuk është riparuar brenda 5 ditëve të punës pas datës së detyrimit;

b) Huamarrësi nuk kryen siç duhet ndonjë term, sipërmarrjeje ose detyrim sipas kësaj marrëveshjeje;

c) Ndonjë certifikatë, përfaqësim ose sipërmarje që është bërë nga Huamarrësi sipas kësaj marrëveshjeje ose që përmbahet në ndonjë certifikatë, deklaratë ose lajmërim të parashikuar nga ose në emër të Huamarrësit sipas kësaj marrëveshjeje provohet të jetë jokorrekte materialisht;

d) Huamarrësi ndërpret pagesën e borxhit të tij në përgjithësi, shpall moratorium ose ndonjë mënyre në përfitim të ndonjërit ose më shumë kreditorëve ose do të konsiderohet i paaftë të paguajë borxhet e tij.

Neni 14
Lajmërimet dhe korrespondenca

14.1. Lajmërimet dhe kërkesat e dhëna ose të bëra mund të dërgohen me teleteks, cable ose postë të regjistruar duke përdorur adresën e regjistruar më poshtë;

Për Eksportfinans:
Eksportfinas A S A
P.O. Box 1601, Vika
N- 0119 Oslo
Norvegji

Teleks:78213 exfin
Fax:47 22832237
Tel:47 22012201

Për huamarrësin:
Ministria e Financave
Bul. Dëshmorët e Kombit
Tiranë

14.2. Huamarrësi dhe Eksportfinans do të informojnë njëri-tjetrin për ndonjë ndryshim në adresat e tyre të specifikuara në seksionin 14.1 me sipër.

14.3. Të gjitha lajmërimet, kërkesat ose komunikimet e tjera nga Huamarrësi dhe Eksportfinans sipas kësaj marrëveshjeje do te behen në anglisht, ose nëse në një gjuhë tjetër, duhet t'i bashkëngjitet përkthimi i vërtetuar në anglisht.

14.4. Versioni anglisht do të mbizotërojë në ndonjë rast.

Neni 15
Ligji rregullues / Juridiksioni

15.1. Kjo marrëveshje dhe notat premtuese do te rregullohen dhe interpretohen në përputhje me normat e Mbretërisë së Norvegjisë.

15.2. Për mosmarrëveshje që lindin në lidhje me këtë marrëveshje, Huamarrësi i dorëzohet në mënyrë të parevokueshme dhe pa kushte Juridiksionit të Gjykatës së Arbitrazhit në Stokholm, Suedi, në përputhje me rregullat e institutit të Arbitrazhit në dhomën e tregëtisë së Stokholmit. Huamarrësi dhe Eksportfinans do të emërojnë një arbitër. Këta të dy do të emërojnë një të tretë, i cili do të jetë kryetari, brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të procesit në përputhje me seksionin 15.3 më poshtë, dhe nëse kjo nuk ndodh, secila palë mund t'i drejtohet Presidentit të Stokholmit Tingsrat, Suedi, për emërimin e një arbitri, ose kryetarit. Procedurat do të bëhen në anglisht.

15.3. Huamarrësi bie dakord të emërojë Ambasadën e R SH, Stockholm për të marrë

lajmërimin për arbitrazh. Një kopje do t'i dërgohet Huamarrësit me postë nga Eksportfinans në adresën e dhënë, por nëse Huamarrësi nuk e merr këtë, kjo nuk do të prekë procesin.

Asgjë nuk do të prekë të drejtën për proces në ndonjë mënyrë tjetër të lejuar nga ligji.

15.4. Vendimi i arbitrazhit, mund të zbatohet pa padi, nëse lejohet nga ligji i zbatueshëm ose ndonjë traktat, në ndonjë juridiksion në të cilin Huamarrësi mban ndonjë mjet.

15.5. Huamarrësi heq dorë nga imuniteti sovran të cilin mund ta mbajë në lidhje me këtë marrëveshje.

Neni 16

Dispozita të ndryshme

16.1. Transferimi

Eksportfinans ka të drejtën e transferimit të të drejtave dhe sigurive sipas kësaj marrëveshjeje pjesërisht ose në tërësi.

16.2. Heqja dorë, ndreqja

Asnjë mungesë ose vonesë në ushtrimin e të drejtave të saj nuk do te konsiderohet për Eksportfinans si heqje dore nga ato, as nuk do të përbëjë mbarimin e të drejtës ndonjë ushtrim i pjesshëm i saj. Të drejtat dhe ndreqjet janë kumulative, dhe jo ekskluzive nga ndonjë të drejtë ose ndreqje që sigurohet nga ligji Norvegjez.

16.3. Amendamentet

Kjo marrëveshje nuk mund të ndryshohet përveçse me një instrument të shkruar nga ose në emër të të dy palëve dhe me pëlqimin e Garantuesit dhe GIEK.

16.4. Vlefshmëria e dispozitave

Ndonjë dispozitë e kësaj marrëveshjeje që ndalohet ose nuk është e detyrueshme në ndonjë juridiksion do të jetë inefektive në lidhje me këtë, në masën që nuk prek dispozitat e tjera ose vlefshmerinë e saj në juridiksionet e tjera. Palët në ndonjë rast, do të negociojnë në mirëbesim, qe t'i bëjnë këto amendamente efektive sipas qëllimeve të kësaj marrëveshjeje .

16.5. Titujt

Titujt e seksioneve dhe të nënseksioneve të kësaj marrëveshjeje nuk do të përbëjnë pjesë të kësaj marrëvëshjeje ose përdoren për qëllime interpretimi.

16.6. Ndryshimet në ligj ose rrethana

Në rastin kur ndonjë ligj ose rregull do ta bëjnë të paligjshme dhënien e Huasë nga Eksportfinans, atëherë, detyrimi i Eksportfinans për të bërë disbursime të tjera do të mbarojë dhe të gjithë shumat e tjera që i detyrohen asaj do të bëhen të detyrueshme dhe të ripagueshme.

Palët duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre nënshkruajnë këtë marrëveshje në datën e shkruar më sipër në _____.

Kjo marrëveshje nënshkruhet në dy kopje origjinale, një për secilën palë.

Republika e Shqipërisë	Eksportfinans
Anastas Angjeli	**Johansen Tor**
Përfaqësues i autorizuar	Përfaqësues i autorizuar

U dorëzua për shtyp më 19.6.2000
Doli nga shtypi më 19.6.2000

Tirazhi: 3700 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Tipografia Ushtarake"

Çmimi: 150 lekë